FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 77	2002	Dhjetor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Urdhër i Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit nr.114, datë 22.11.2002	Për miratimin e rregullores "Për procedurat dhe kriteret e licencimit të veprimtarisë: agjenci turistike udhëtimi dhe agjenci të transportit turistik"……..	2135
Rregullore e Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit nr. 1, datë 22.11.2002	Për procedurat dhe kriteret e licencimit të veprimtarisë: agjenci turistike udhëtimi dhe agjenci të transportit turistik ……	2135
Vendim i Gjykatës së Lartë nr. 2, datë 14.10.2002	Me objekt krimin e vrasjes me dashje, parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal……	2145
Vendim i Gjykatës së Lartë nr. 4, datë 14.10.2002	Me objekt kryerjen e veprës penale të vrasjes me dashje në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 76 e 25 të Kodit Penal… ……	2152
Vendim i Gjykatës së Lartë nr. 5, datë 10.10.2002	Me objekt njohjen e vendimit penal të Gjykatës së Apelit Selanik (Greqi) nr.651, datë 21.9.1999, në ngarkim të shtetasit shqiptar Lutfi Daci.……	2158

Vendim i Gjykatës së Lartë nr. 6, datë 11.10.2002	Me objekt rishikimin e vendimit penal të formës së prerë nr. 85, datë 17.3.2000, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër……....	2166
Vendim i Gjykatës së Lartë nr. 7, datë 11.10.2002	Me objekt mosekzekutimin e vendimit penal të formës së prerë, duke u përjashtuar nga vuajtja e mëtejshme e dënimit, për shkak të parashkrimit dhe shuarjes së tij…… ……	2173

U R D H Ë R
Nr. 114, date 22.11.2002

PER "MIRATIMIN E RREGULLORES "PER PROCEDURAT DHE KRITERET E LICENCIMIT TE VEPRIMTARISE: AGJENCI TURISTIKE UDHETIMI DHE AGJENCI TE TRANSPORTIT TURISTIK""

Ne mbeshtetje te pikes 4 te nenit 102, te Kushtetutes se Shqiperise, dhe te vendimit te Keshillit te Ministrave nr.89, date 1.3.1993 "Per dhenien e licencave per ushtrimin e veprimtarive turistike,

U R D H E R O J:

Miratimin e rregullores "Per procedurat dhe kriteret e licencimit te veprimtarise: agjenci turistike udhetimi dhe agjenci te transportit turistik" bashkelidhur ketij urdheri.

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere dhe botohet ne Fletoren Zyrtare.

MINISTRI
Besnik Dervishi

RREGULLORE
Nr.1, date 22.11.2002

PER PROCEDURAT DHE KRITERET E LICENCIMIT TE VEPRIMTARISE: AGJENCI TURISTIKE UDHETIMI DHE AGJENCI TE TRANSPORTIT TURISTIK

KREU I
DISPOZITA TE PERGJITHSHME

OBJEKTI I RREGULLORES DHE FUSHA E VEPRIMIT

Neni 1

Kjo rregullore percakton dhe shtrin fushen e veprimit te saj ne:

1. organizimin dhe funksionimin e strukturave qe merren me procedurat e licencimit te subjekteve;
2. klasifikimin e veprimtarise turistike, perkatesisht ne ushtrimin e kesaj veprimtarie si agjenci turistike udhetimi dhe ne ate te transportit turistik;
3. kushtet dhe kriteret qe duhen plotesuar per tu pajisur me licence per keto veprimtari;
4. te drejtat qe kane personat fizike dhe juridike per t'u pajisur me licence si dhe detyrimin e Ministrise se Rregullimit te Territorit dhe Turizmit per trajtim konform dispozitave ligjore te kerkesave te tyre.

Neni 2

Asnje subjekt nuk lejohet te ushtroje veprimtari turistike si agjenci turistike udhetimi dhe ne ate te transportit turistik ne rast se nuk disponon licence.

Neni 3

Objekti i veprimtarise turistike

Objekt i veprimtarise turistike si agjenci turistike udhetimi, konsiderohen kryerja e sherbimeve

turistike ndaj klienteve turiste vendas dhe te huaj, individuale ose te organizuar ne grupe, te programuara paraprakisht ose sipas deshires se klienteve turiste dhe kryesisht:

a) - organizimi i udhetimeve per pushime individuale ose kolektive;

- organizimi i pritje-percjelljes se turisteve, sherbimi i guides, perkthyesit, etj;

- organizimi i vizitave ne qytete, muze, monumente historike dhe kulturore,ekskursione ne natyre, shfaqje dhe spektakle muzikore ose kulturore etj;

- dhenia e informacioneve per udhetime dhe pushime turistike;

b) - rezervimi i vendeve te fjetjes ne njesite akomoduese turistike, si dhe porositja e ushqimit ne bar - restorante turistike;

- rezervimi i vendeve ne mjetet e transportit turistik, ose venia ne dispozicion me qera pjesore ose totale e ketyre mjeteve;

c) - ndermjetesimi me shitesit kryesore te produktit turistik (tour-operatore).

Per kryerjen e sherbimeve turistike, perfshire ne objektin e veprimtarise se saj,agjencia turistike hyn ne marredhenie dhe lidh marreveshje kontraktore vetem me subjekte juridike ose fizike, vendas ose te huaj, me veprimtari turistike te licencuara qe operojne ne sektorin turistik si akomodim, transport, tour-operatore, etj, te cilet i kryejne dhe i ofrojne sherbimet e ndryshme turistike edhe drejtperdrejte.

Neni 4

Objekt i veprimtarise turistike te transportit turistik per udhetare konsiderohen kryerja e sherbimeve te transportit ndaj klienteve turiste vendas dhe te huaj, individuale ose te organizuara ne grupe, te programuara paraprakisht ose sipas deshires se tyre, brenda ose jashte vendit dhe kryesisht:

- kryerja e transportit vajtje-ardhje per pushime ne qendra akomoduese;

- vajtje-ardhje drejt pikave te kalimit kufitar;

- vizita dhe ekskursione brenda qytetit, muzeume, qendra arkeologjike, objekte historiko-kulturore dhe fetare, qendra atraktive turistike, etj.;

- transport per qellime turistike te tjera.

Veprimtaria turistike e transportit turistik per udhetare realizohet mbi bazen e marreveshjeve ose kontratave te arritura ndermjet personave juridike ose fizike te pajisura me licence per ushtrim te kesaj veprimtarie dhe personave juridike ose fizike qe porositin kryerjen e sherbimeve te tilla turistike, si agjenci turistike udhetimi, tour-operatore, njesi akomoduese turistike, si dhe me marreveshje te drejtperdrejte me klientet udhetare.

Neni 5

Licenca e ushtrimit te veprimtarise turistike si agjenci turistike udhetimi ose transport turistik jepet:

Me afat njevjeçar, per lejimin e fillimit te ushtrimit te veprimtarise turistike si agjenci turistike udhetimi ose transport turistik dhe riperterihet per lejimin e vazhdimit te ushtrimit te veprimtarise, vetem atehere kur treguesit ekonomiko-finaciare dhe statistikore te ushtrimit vjetor, pasqyrojne vazhdimesine e veprimtarise turistike, si dhe kur subjekti kerkues ploteson kerkesat dhe detyrimet e parashikuara ne kete rregullore.

Me afat 3-vjeçar, mund te jepet per lejimin e vazhdimit te ushtrimit te veprimtarise turistike si agjenci turistike udhetimi ose transport turistik, vetem atehere kur treguesit ekonomiko-financiar dhe statistikore gjate 2 viteve te meparshme te ushtrimit vjetor, pasqyrojne rritjen dhe qendrueshmerine e rezultateve te veprimtarise turistike, si dhe kur subjekti kerkues ploteson kerkesat dhe detyrimet e parashikuara ne kete rregullore.

KREU II
ORGANIZIMI I STRUKTURAVE FUNKSIONALE DHE PROCEDURAT ADMINISTRATIVE PER MARRJEN E LICENCAVE PER USHTRIMIN E VEPRIMTARISE TURISTIKE

Neni 6

Proçedurat administrative per pranimin dhe shqyrtimin e kerkesave te subjekteve per marrjen e licences se ushtrimit te veprimtarise turistike, dhenien, riperteritjen, refuzimin ose heqjen e licences, mbikqyrjen e ushtrimit te veprimtarise turistike ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, etiken ne turizem dhe dispozitat e kesaj rregulloreje, ndiqen nga Drejtoria qe mbulon aktivitetin e Marketing - Promocionit dhe Standardeve Turistike dhe Drejtoria qe mbulon aktivitetin e liçensimit ne MRRTT.

Neni 7

Drejtoria qe mbulon aktivitetin e Marketing - Promocionit dhe Standardeve Turistike ka te drejten dhe detyren funksionale:

- orientimin, ndjekjen dhe mbikqyrjen e veprimtarise turistike per ushtrimin e saj ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, etiken ne turizem, dispozitat e kesaj rregulloreje, si dhe kerkesat profesionale bashkekohore ne sektorin e agjencive turistike te udhetimeve dhe te transportit turistik;
- shqyrtimin dhe vleresimin e kerkesave te subjekteve per liçensim;
- verifikimin per plotesimin e kritereve, kushteve per liçensimin e veprimtarise dhe per permbushjen e detyrimeve te percaktuara ne kete rregullore;
- perpilon proçesverbalin vleresues per aprovimin pse refuzimin e kerkeses se subjektit per marrjen ose riperteritjen e licences;
- propozon per dhenien ose refuzimin e licences, ne varesi te plotesimit ose mosplotesimit te kritereve dhe kushteve te percaktuara ne kete rregullore;
- propozon per heqjen ose pezullimin e licences, per shkelje te renda dhe te perseritura ne moszbatimin e detyrimeve te percaktuara ne kete rregullore.

Drejtoria qe mbulon aktivitetin e licensimit ne MRRTT ka te drejte dhe detyre funksionale per:

- komunikimin zyrtar me subjektin gjate tere proçedurave te liçensimit;
- marrjen ne dorezim te kerkeses me dokumentacionin shoqerues, si dhe dhenien e sqarimeve te nevojshme per plotesimin e tij sipas kesaj rregulloreje;
- njoftimin e subjektit per miratimin ose refuzimin e dhenies se licences;
- pergatitjen e licences dhe dorezimin e saj subjektit te liçensuar;
- ruajtjen dhe arshivimin e kerkesave te shqyrtuara, te bashkelidhura me dokumentacionin shoqerues perkates, si dhe te licencave te pavlefshme.

Neni 8

Kerkesa e subjektit quhet zyrtarisht e dorezuar, duke filluar nga data e plotesimit te dokumentave shoqeruese, ligjerisht te rregullta, ne perputhje me kerkesat e kesaj rregulloreje dhe e protokollimit ne regjistrin qe ndodhet ne Drejtorine qe mbulon aktivitetin e liçensimit ne MRRTT.

Neni 9

Dosjet e kerkesave te subjekteve kerkues me dokumentacion te rregullt dhe te plotesuar, dorezohen çdo jave dhe me procesverbal, ne Drejtorine qe mbulon aktivitetin e Marketing-Promocionit dhe Standardeve Turistike, per shqyrtim dhe vleresim.

Neni 10

Drejtoria qe mbulon aktivitetin e Marketing-Promocionit dhe Standardeve Turistike, shqyrton dhe vlereson kerkesat e dorezuara, perpilon process-verbalin vleresues per aprovimin ose refuzimin e kerkeses se subjektit per marrjen ose riperteritjen e licences, process-verbal, i cili nenshkruhet prej Drejtorit te Drejtorise dhe sektorit perkates.

Drejtoria qe mbulon aktivitetin e Marketing-Promocionit dhe Standardeve Turistike, pergatit vendimin per dhenien e licences se ushtrimit te veprimtarise turistike si: agjenci turistike udhetimi ose transport turistik, vendim i cili i shoqeruar me procesverbalin vleresues, i paraqitet per miratim Ministrit ose personit te autorizuar prej tij.

Neni 11

Drejtoria qe mbulon aktivitetin e licencimit ne MRRTT brenda 15 diteve nga marrja e vendimit dhe mbi bazen e tij, njofton zyrtarisht subjektin per miratimin ose refuzimin e kerkeses se tij per licencim dhe pergatit licencen sipas standardeve dhe formateve bashkelidhur kesaj rregulloreje.

Formatet e licencave per ushtrimin e veprimtarise turistike si agjenci turistike udhetimi dhe te transportit turistik jane dokumente standart sipas modelit 1 dhe 2, bashkelidhur kesaj rregulloreje.

Licenca e ushtrimit te veprimtarise turistike si:agjenci turistike udhetimi ose transport turistik nenshkruhet nga Ministri ose personi i autorizuar prej tij.

Licenca permban keto te dhena: emrin e personit juridik ose fizik; emrin e drejtuesit; adresen e selise qendrore dhe te filialeve; te dhena mbi mjetin turistik ne licencen e transportit turistik; data e leshimit dhe afati i licences.

Terheqja e licences duhet te behet prej subjektit brenda 30 diteve nga data e leshimit te saj. Mosterheqja brenda ketij afati shkakton anullimin e saj.

Drejtoria qe mbulon aktivitetin e liçensimit ne MRRTT arshivon praktikat ne nje regjister vjetor sipas muajit te vitit kalendarik te dorezimit. Dokumentacioni ruhet ne kete Drejtori per nje periudhe 10-vjeçare dhe dorezohet, me kalimin e ketij afati, ne arshiven qendrore.

Ne rastin e mosmiratimit te kerkeses se rregullt per marrjen e licences se ushtrimit te veprimtarise turistike, subjektit i lind e drejta e ankeses sipas dispozitave te Kodit te Procedurave Administrative.

Neni 12

Licencat jane subjekt i pageses ne zyren e llogarise se Ministrise qe i leshon ato, kundrejt mandat-arketimit dhe para terheqjes se licences sipas listes te tarifave te miratuara, bashkelidhur kesaj rregulloreje.

Te ardhurat qe grumbullohen nga licencat, shenohen ne nje rregjister te vecante, ne Drejtorine qe mbulon aktivitetin e liçensimit ne MRRTT me te gjitha ekstremet e tyre. Keto te dhena ne fund te muajit i dorezohen zyres se llogarise per te bere rakordimet perkatese.

KREU III
KRITERET DHE KUSHTET QE DUHET TE PLOTESOJNE SUBJEKTET JURIDIKE SIPAS VEPRIMTARIVE NE FUSHAT E TURIZMIT

KAPITULLI I
KRITERET DHE KUSHTET QE DUHET TE PLOTESOJNE SUBJEKTET JURIDIKE PER MARRJEN E LICENCES PER USHTRIMIN VEPRIMTARISE TURISTIKE SI AGJENCI TURISTIKE UDHETIMI

Neni 13

Kerkesa per pajisjen me licencen e ushtrimit te veprimtarise turistike si agjenci turistike udhetimi behet nga drejtuesi ligjor i shoqerise ose nga personi i autorizuar prej tij.

- Licenca si me siper jepet ne emer te personit juridik.
- Subjekti turistik i liçensuar ka te drejte te kete edhe filiale duke i deklaruar ato qe ne fillim te

aktivitetit te tyre.

- Per ushtrimin e veprimtarise turistike si agjenci turistike udhetimi ne kushte normale, per te kontaktuar dhe kryer sherbime te ndryshme me klientelen, subjekti kerkues duhet te kete ne pronesi ose qirramarje nje zyre me dy ambjente me nje siperfaqe minimale 16m2 (te dyja) si dhe pajisjet e nevojshme per komunikim si telefon, faks dhe kompjuter.

Neni 14

Drejtori ose administratori i agjencise turistike duhet te zoteroje aftesite e nevojshme profesionale per drejtimin, organizimin dhe funksionimin e agjencise turistike, te vertetuara me dokumente, si vijon:

- diplomen e arsimit te larte;
- deshmi per pervoje pune ose kualifikim profesional ne fushen e turizmit.

Personeli operues i agjencise turistike duhet te jete I specializuar ne kryerjen e veprimeve dhe sherbimeve turistike. Per kete duhet te paraqiten dokumentet si vijon:

- deftesen/diplomen e arsimit te mesem porofesional ose te pergjithshem;
- kontrate punesimi sipas Kodit te Punes;
- leje qendrimi per punonjes me shtetesi te huaj;
- vertetimin e sigurimeve shoqerore.

Neni 15

Per krijimin e besueshmerise ekonomike dhe garantimin e veprimtarise turistike, si kusht per pajisjen me licencen e ushtrimit te veprimtarise turistike si agjenci turistike udhetimi, subjekti kerkues duhet te beje paraprakisht derdhjen si depozite garancie te paprekeshme dhe te ngurtesuar pa afat, ne llogarine e Ministrise se Rregullimit te Territorit dhe Turizmit ne nje prej Degeve te Bankes se Kursimeve, te shumes prej:

- 2000 euro (ose vlefta ne leke sipas kursit bankar te kembimit, diten e derdhjes se depozites bankare) per licence me afat njevjeçar;
- 3000 euro (ose vlefta ne leke sipas kursit bankar te kembimit, diten e derdhjes se depozites bankare) per licence me afat 3-vjeçar.

Depozita e garancise eshte e paprekshme dhe e ngurtesuar gjate gjithe periudhes se ushtrimit te veprimtarise turistike si agjenci turistike udhetimi. Derdhja dhe kushtet e prekjes se saj percaktohen me akt-marreveshje paraprake midis vete subjektit dhe bankes.

Depozita e garancise mund te terhiqet vetem kur subjekti paraqet zyrtarisht kerkesen me shkrim ne Drejtorine qe mbulon aktivitetin e liçensimit ne MRRTT per mbylljen e veprimtarise turistike, kerkese e cila shqyrtohet prej Drejtorise qe mbulon aktivitetin e Marketing - Promocionit dhe Standardeve Turistike dhe miratohet prej Ministrit.

Neni 16

Subjekti juridik, per marrjen e licences per ushtrimin e veprimtarise turistike si agjenci turistike udhetimi duhet te paraqese dokumentet origjinale ose kopje te noterizuara, si me poshte:

1. formulari-tip me te dhenat e pergjithshme, i plotesuar dhe nenshkruar rregullisht prej perfaqesuesit ligjor te subjektit kerkues, te shoqeruar me dy fotografi te drejtuesit te agjencise turistike, sipas modelit 3, bashkelidhur kesaj rregulloreje;
2. vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane per regjistrimin si person juridik me objekt veprimtarie nder te tjera edhe si agjenci turistike udhetimi;
3. dokumentat vertetues per kualifikimin profesional per drejtuesin, si dhe personelin operues te agjencise turistike;
4. vertetim te gjendjes gjyqesore per drejtuesin ligjor te agjencise turistike (data e deshmise te jete

jo me vone se 3 muaj nga data e dorezimit te kerkeses per licence);

5. dokumentin vertetues per pronesine ose qiramarrjen e ambjenteve te zyrave (seline qendrore dhe zyrat perfaqesuese filiale) per periudhen kohore te licences se kerkuar, gent-planin si dhe fotografi per ambientet dhe reklamen e agjencise (data e dokumentit te jete jo me vone se 1 muaj nga data e dorezimit te kerkeses per licence);

6. dokumentin bankar qe verteton derdhjen e depozites se garancise dhe akt - marrveshjen midis vete subjektit dhe bankes;

7. deklarate e subjektit kerkues, i cili merr persiper te zbatoje te gjitha detyrimet dhe dispozitat e percaktuara ne kete rregullore.

Neni 17

Subjektet juridike te licencuara, jane te detyruara (ne cdo 3 muaj) te informojne rregullisht Drejtorine qe mbulon aktivitetin e Marketing-Promocionit dhe Standardeve Turistike, ne perputhje dhe ne zbatim te Ligjit Nr.7687,date 16.3.1993 "Per Statistiken", per te dhenat statistikore mbi veprimtarine e tyre turistike dhe per bashkerendimin e veprimtarive promocionale turistike.

Neni 18

Subjektet juridike te licencuara, jane te detyruara t'i pergjigjen pyetesoreve qe dergohen ne menyre periodike nga Drejtoria qe mbulon aktivitetin e Marketing-Promocionit dhe Standardeve Turistike.

KAPITULLI II
KERKESAT PER RINOVIMIN E LICENCES PER USHTRIMIN VEPRIMTARISE TURISTIKE SI AGJENCI TURISTIKE UDHETIMI

Dokumentet per rinovimin e licencave paraqiten 30 dite para perfundimit te afateve te shenuara mbi dokumetat e mesiperme ose sipas percaktimeve te vecanta qe mund te behen me poshte.

Neni 19

Kerkesen per rinovimin e licences e shoqerojne dokumentet origjinale ose kopje te noterizuara, si me poshte:

1. formulari-tip me te dhenat e pergjithshme, i plotesuar dhe nenshkruar rregullisht prej perfaqesuesit ligjor te subjektit kerkues, te shoqeruar me dy fotografi te drejtuesit te agjencise turistike, sipas modelit 4, bashkelidhur kesa rregulloreje;

2. deklaraten e te ardhurave te realizuara nga aktiviteti turistik per vitin paraardhes, ose per te dy vitet paraardhese ne rastet e kerkesave per licence 3 vjeçare, ne perputhje me dokumentacionin e dorezuar ne organet tatimore;

3. dokumentat per kualifikimin profesional per drejtuesin, si dhe personelin operues te agjencise turistike, ne rast ndryshimi;

4.vertetim te gjendjes gjyqesore per drejtuesin e agjencise. (data e deshmise te jete jo me vone se 3 muaj nga data e dorezimit te kerkeses per licence);

5. dokumentin vertetues per pronesine ose qiramarrjen e ambienteve te zyrave (seline qendrore dhe zyrat perfaqesues filiale) per periudhen kohore te licences se kerkuar per riperterirje dhe, ne rast ndryshimi, gent-planin dhe fotografi per ambientet dhe reklamen;

(data e dukumentit te jete jo me vone se 1 muaj nga data e dorezimit te kerkeses per licence).

6. mandat-arketimet qe vertetojne pagesen e tarifes se sherbimit per rinovimin e licences dhe kontributit vjetor ne fondin promocional turistik;

7. te vertetoje me dokumentacion pjesen e veprimtarise turistike "per numrin e turisteve qe

Agjencia Turistike ka trajtuar ne Shqiperi " per rinovimin e licencave 3-vjeçare;

8. deklarate e subjektit kerkues, i cili merr persiper te zbatoje te gjitha dispozitat e percaktuara ne kete rregullore.

Neni 20

Kur subjekti juridik i licensuar do te mbylle veprimtarine turistike si agjenci turistike udhetimi dhe rrjedhimisht, çbllokimin e depozites se garancise bankare, ai duhet te paraqese zyrtarisht dokumentet si me poshte:

- deklarimin zyrtar me shkrim per mbylljen e veprimtarise turistike si agjenci turistike udhetimi te nenshkruar rregullisht ne emer te shoqerise prej drejtuesit ligjor ose administratorit;
- licencen origjinale te ushtrimit te veprimtarise turistike si agjenci turistike udhetimi per vitin fiskal ne vazhdim.

KAPITULLI III

KRITERET DHE KUSHTET QE DUHET TE PLOTESOJNE SUBJEKTET FIZIKE /JURIDIKE PER MARRJEN E LICENCES PER USHTRIMIN E VEPRIMTARISE TURISTIKE TE TRANSPORTIT TURISTIK

Neni 21

Personi fizik ose juridik ka te drejte te paraqese kerkesen e tij per tu pajisur me licencen e ushtrimit te veprimtarise turistike te transportit turistik kur ploteson keto kushte:

- vendimin e gjykates qe verteton se ne objektin e veprimtarise se tij perfshihet ushtrimi i veprimtarise turistike te transportit turistik.
- Disponon ne pronesi ose ne perdorim mjet ose mjete te transportit "turistik"(autobus,minibus, taksi, etj), te pajisura me lejen e qarkullimit rrugor.
- Nuk duhet te jete denuar per vepra penale kunder personit dhe/ose pasurise se shtetasve dhe asaj publike si dhe nuk duhet te jete denuar penalisht per shkelje te Kodit Rrugor.
- Te jete i pajisur me patente drejtimi te kategorise "D".

Ne rast kur mjeti i transportit nuk drejtohet prej vete subjektit kerkues, te njejtat dokumenta te aftesise se drejtimit te mjetit te transportit turistik jane te detyrueshme per drejtuesin e mjetit te transportit te punesuar prej tij.

Neni 22

Ushtrimi i veprimtarise turistike te transportit turistik mund te kryhet vetem me mjete transporti te cilesuara "turistike" per te mundesuar ofrimin e sherbimeve te nevojshme dhe kushteve te pershtatshme te komfortit gjate transportit per qellime turistike.

Mjetet e transportit, te percaktuara dhe te deklaruara prej subjektit kerkues te licences per kryerjen e veprimtarise turistike te transportit turistik per udhetare, do te cilesohen si "turistike", atehere kur ai verteton plotesimin e kerkesave vijuese :

- mjet ne gjendje te mire teknike dhe i mirembajtur;
- mjet prodhim i viteve te fundit, por jo shume se 10 vjet, ose jo me shume se 400 mije km;
- mjet i pajisur me sistemin e ajrit te kondicionuar;
- mjet i pajisur me paketen sanitare te ndihmes se shpejte;
- mjet i pajisur me mikrofon, (autobuze);
- mjet i pajisur me akt-kontrolli teknik dhe kolaudimi (modeli 020 ose 021) sipas llojit te mjetit te transportit, kategorise se transportit, si dhe lejes per te drejte transporti turistik kombetar ose nderkombetar.

Neni 23

Subjekti, (personat fizike dhe juridike), per marrjen e licences per ushtrimin e veprimtarise turistike te transportit turistik duhet te paraqese dokumentet origjinale ose kopje te noterizuara, si me poshte:

1. formularin-tip bashkelidhur me te dhenat e pergjithshme, te plotesuar dhe nenshkruar rregullisht prej subjektit kerkues, bashke me dy fotografi per subjektin kerkues dhe tre fotografi te mjetit te transportit turistik (me pamje ballore, anesore dhe te brendeshme), sipas modelit 5, bashkelidhur kesaj rregulloreje;

2. vendimin e gjykates se rrethit per rregjistrimin si person juridik ose fizik, me objekt veprimtarie ushtrimin e veprimtarise te transportit turistik per udhetare;

3. dokumentin (patenten) per aftesine e drejtimit te mjetit te transportit turistik per udhetare (sipas llojit dhe kategorise se mjetit te transportit) per vete pronarin, ose drejtuesin e punesuar bashke me kontraten e punesimit (jo me vone se 3 muaj);

4. vertetim te gjendjes gjyqesore. (data e deshmise te jete jo me vone se 3 muaj nga data e dorezimit te kerkeses per licence);

5. dokument mbi pronesine e mjetit te transportit turistik (data e dokumentit te jete jo me vone se 3muaj nga data e dorezimit te kerkeses per licence);

6. aktin e kontrollit teknik dhe kolaudimit te mjetit te transportit turistik per udhetare brenda dhe / ose jashte vendit sipas llojit dhe kategorise se tij (jo me vone se 3 muaj);

7. mandatet e arketimeve qe vertetojne pagesen e tarifes se sherbimit per pajisjen me licence dhe kontributin vjetor ne fondin promocional turistik;

8. raportimin periodik te te dhenave statistikore mbi veprimtarine turistike te transportit turistik;

9. deklarate e subjektit kerkues, i cili merr persiper te zbatoje dispozitat dhe detyrimet e percaktuara ne kete rregullore.

KAPITULLI IV
KERKESAT PER RINOVIMIN E LICENCES PER USHTRIMIN VEPRIMTARISE TURISTIKE TE TRANSPORTIT TURISTIK

Neni 24

Subjekti, (personat fizike dhe juridike), per rinovimin e licences per ushtrimin e veprimtarise turistike te transportit turistik duhet te paraqese dokumentet origjinale ose kopje te noterizuara, si me poshte:

1. formularin-tip bashkelidhur me te dhenat e pergjithshme, te plotesuar dhe nenshkruar rregullisht prej subjektit kerkues, bashke me dy fotografi per subjektin kerkues dhe tre fotografi te mjetit te transportit turistik (me pamje ballore, anesore dhe te brendeshme), sipas modelit 6, bashkelidhur kesaj rregulloreje;

2. vendimin e gjykates se rrethit per rregjistrimin si person juridik ose fizik, me objekt veprimtarie ushtrimin e veprimtarise te transportit turistik per udhetare;

3. dokumentin (patenten) per aftesine e drejtimit te mjetit te transportit turistik per udhetare (sipas llojit dhe kategorise se mjetit te transportit) per vete pronarin, ose drejtuesin e punesuar bashke me kontraten e punesimit (jo me vone se 3 muaj);

4. vertetim te gjendjes gjyqesore.(data e deshmise te jete jo me vone se 3 muaj nga data e dorezimit te kerkeses per licence);

5. dokument mbi pronesine e mjetit te transportit turistik .(data e dokumentit te jete jo me vone se 3 muaj nga data e dorezimit te kerkeses per licence);

6. aktin e kontrollit teknik dhe kolaudimit te mjetit te transportit turistik per udhetare brenda dhe (ose jashte vendit sipas llojit dhe kategorise se tij) (jo me vone se 3 muaj);

7. mandatet e arketimeve qe vertetojne pagesen e tarifes se sherbimit per pajisjen me licence dhe

kontributin vjetor ne fondin promocional turistik;

8. raportimin periodik te te dhenave statistikore mbi veprimtarine turistike te transportit turistik;

9. deklarate e subjektit kerkues, i cili merr persiper te zbatoje dispozitat dhe detyrimet e percaktuara ne kete rregullore.

Dokumentet per rinovimin e licencave, paraqiten 30 dite para perfundimit te afateve te shenuara ne licence.

Neni 25

Kur subjekti i licensuar kerkon te mbylle aktivitetin, ai duhet te paraqese ne Drejtorine qe mbulon aktivitetin e liçensimit ne MRRTT dokumentet e meposhtme:

- kerkesen zyrtare ku te deklaroje mbylljen e veprimtarise turistike te transportit turistik;
- licencen origjinale te ushtrimit te veprimtarise turistike te transportit turistik per vitin fiskal ne vazhdim.

KREU IV
PAVLEFSHMERIA E LICENCAVE DHE MASAT DISIPLINORE NDAJ SUBJEKTEVE

Neni 26

Licencat per ushtrimin e veprimtarise si agjenci turistike udhetimi dhe ne ate te transportit turistik behen te pavlefshme, ne rast se subjektet juridike nuk e fillojne veprimtarine per te cilen u jane dhene keto licenca brenda 60 diteve nga data e leshimit te tyre.

Licenca mund te hiqet kur ne veprimtarine e subjekteve si agjenci turistike udhetimi dhe ne ate te transportit turistik konstatohen shkelje te neneve te kesaj rregulloreje qe rregullojne veprimtarine perkatese.

Neni 27

Heqja e se drejtes per ushtrimin e aktivitetit si agjenci turistike udhetimi dhe te transportit turistik apo pezullimin e perkohshem te ketyre veprimtarive, propozohet nga Drejtoria qe mbulon aktivitetin e Marketing Promocionit dhe Standardeve Turistike dhe miratohet nga Ministri.

Masat, sipas shkeljeve te bera gjate ushtrimit te veprimtarise jane me heqje te se drejtes te ushtrimit te aktivitetit te licensuar: 6 muaj, 1 vit, 3 vjet.

Masat e marra i njoftohen subjektit perkates si dhe deges se tatim taksave ku ushtron veprimtarine subjekti.

Neni 28

Per çdo mase te marre ndaj subjekteve, ne zbatim te nenit 26 te kesaj rregulloreje, personat fizike dhe juridike kane te drejten e ankimit sipas dispozitave te Kodit te Procedurave Administrative.

Neni 29

Rregullorja per ushtrimin e veprimtarise se agjencive te udhetimeve turistike, miratuar me shkresen nr.59/1 date 11.11.1998, te Komitetit te Zhvillimit te Turizmit dhe rregullorja per ushtrimin e veprimtarise turistike te transportit turistik, e miratuar me shkresen nr.719 date 4.10.2000 nga Komiteti i Zhvillimit te Turizmit, shfuqizohen.

V E N D I M
Nr. 2, date, 14.10.2002

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte te perbere nga:

Thimjo KondiKryesues	Vladimir Metani“
Perikli ZahariaAnetar	Vladimir Bineri“
Kristaq Ngjela“	Metush Saraci“
Spiro Spiro“	Natasha Sheshi“
Ylvi Myrtja“	Nikoleta Kita“
Agron Lamaj“	Artan Hoxha“
Bashkim Caka“	Irma Bala“
Valentina Kondili“	Evgjeni Sinoimeri“

ne seancat gjyqesore te dates 28.5.2002 dhe te dates 14.10.2002, me pjesemarrjen e prokurorit Arqile Lole dhe te avokatit mbrojtes te te pandehurit av.Shuaip Syri, moren ne shqyrtim ceshtjen penale me pale:

I PANDEHUR: GEZIM TAFA, i biri i Rizait, i datelindjes 1969, banues ne Berat.

AKUZUAR:Per krimin e vrasjes me dashje, parashikuar nga neni 76 i K.Penal.

Me vendimin nr. 12, date 19.6.1996, te Gjykates se Rrethit Kolonje, eshte vendosur deklarimi fajtor i te pandehurit Gezim Tafa, per krimin e vrasjes me dashje, parashikuar nga neni 76 i K.Penal dhe denimin e tij me 12 (dymbedhjete) vjet burgim.

Gjykata e Apelit Tirane, me vendimin nr.610, date 16.8.1996, vendosi lenien ne fuqi te vendimit te mesiperme.

Me vendimin nr. 1, date 29.10.2001, te Gjykates te rrethit Kolonje, eshte vendosur rivendosja ne afat e te pandehurit per te bere rekurs ne Gjykaten e Larte, rekurs i cili u paraqit me 10.11.2001.

Ne rekurs kerkohet prishja e vendimit nr.12, date 19.6.1996, i gjykates se rrethit Kolonje dhe pushim i ceshtjes penale, duke parashtruar shkaqet e meposhtme:

- I pandehuri ka qene duke kryer sherbimin e detyrueshem ushtarak ne kufi, me detyre komandant skuadre. Ne oren 0430 te dates 10.6.1990, u dha situate per shkelje kufiri dhe pasi u ngrit nga gjumi, per shkak te kesaj situate, ne zbatim te detyres per bllokimin e kufirit, diktoi nje person qe po vraponte ne drejtim te kufirit, te cilit i beri ndaljen, por meqenese nuk ndaloi, qelloi ne ajer, duke e paralajmeruar edhe me fjale: ndalo se do te qelloj dhe kur shkelesi i kufirit u sul me thike ne dore ne drejtim te tij, i pandehuri qelloi me bresheri dhe e la te vrare.

- Ne keto rrethana, vepra duhej te ishte cilesuar si shkelje e rregullave te sherbimit te rojes ne ruajtjen e kufijve te shtetit, parashikuar nga neni 146 i K.Penal te meparshem.

- Eshte shkelur neni 432/b i K.Pr.Penale, pasi i pandehuri, duke qene ushtarak, eshte gjykuar nga nje gjykate civile.

- Vendimi i gjykates eshte jo llogjik, pasi nga njera ane, pranohet se vepra eshte kryer gjate kohes qe i pandehuri ka qene ne sherbim ne ruajtje te kufirit, nga ana tjeter, deklarohet fajtor per krimin e vrasjes.

- Duke u cilesuar vepra si shkelje e rregullave te sherbimit te rojes ne ruajtje te kufirit, ceshtja penale duhet te pushohet, ne baze te ligjit nr.8202, date 27.3.1997 “Per Amnistine”.

Kolegji Penal i Gjykates se Larte me vendimin nr.194, date 21.3.2002 ka vendosur dergimin e kesaj ceshtjeje per gjykim ne Kolegjet e Bashkuara per te bere njesimin e praktikes gjyqesore.

Ne vendimin e mesiperm Kolegji Penal, nder te tjera shprehet se:

“…. Ndodhur para ketyre rrethanave, d.m.th. para faktit qe, jo vetem rekursi, por edhe kerkesa per rivendosje ne afat per paraqitjen e tij ne Gjykaten e Larte, jane bere nga avokati Shuaip Syri, i pajisur me prokure te posacme, leshuar jo nga vete i gjykuari, por nga i ati, i quajtur Riza Tafa; si dhe para faktit qe nga ana e Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte, ne vendimet, nr.47, date 28.1.1999 dhe nr.386,

date 29.7.1999, ashtu sikurse eshte konstatuar edhe ne vendimin nr.17, date 17.4.2000 te Gjykates Kushtetuese, nuk eshte mbajtur qendrim i njellojte edhe ne lidhje me legjitimimin e mbrojtesit per te kerkuar rivendosjen ne afat per paraqitjen e ankimit, Kolegji Penal i Gjykates se Larte, cmon se, me rastin e gjykimit te ceshtjes penale qe i perket te gjykuarit Gezim Tafa, shihet me vend qe duhet bere njesimi i praktikes gjyqesore…"

Duke marre shkas nga vendimi i Kolegjit Penal, Kolegjet e Bashkuara, per efekt te njesimit te praktikes gjyqesore cmojne t`u japin pergjigje problemeve te meposhteme:

Cila gjykate eshte kompetente per te gjykuar kerkesen per rivendosjen ne afat te ankimit (apelit apo rekusit).

Ne interpretim te nenit 147 te K.Pr.Penale, per te pandehurin e gjykuar ne mungese per shkak se i fshihet gjykimit te ceshtjes (neni 352/4 te K.Pr.Penale), kerkesa per rivendosjen ne afat te ankimit a lejohet te behet nga nje avokat mbrojtes i caktuar kryesisht, ose i caktuar nga familjaret e te pandehurit, apo kjo e drejte i perket ekskluzivisht vetem te pandehurit.

KOLEGJET E BASHKUARA TE GJYKATES SE LARTE,

pasi degjuan relatimin e ceshtjes nga gjyqtaret Natasha Sheshi e Vladimir Bineri, prokurorin Arqile Lole qe kerkoi pranimin e rekursit, avokatin Shuaip Syri qe kerkoi pranimin e rekursit, prishjen e te dy vendimeve e pushimin e ceshtjes penale, e pasi e bisedoi ceshtjen ne teresi,

V E R E J N E:

Gjate gjykimit ne shkalle te pare dhe ne Apel te dy gjykatat kane pranuar faktet dhe rrethanat e ceshtjes si me poshte:

Me daten 09.6.1990 viktima Fatmir Duro, i shoqeruar nga shtetasi Irfan Lici, eshte nisur nga fshati Orman, Korce, ne drejtim te Ersekes dhe me vone ne drejtim te kufirit shteteror ne Leskovik.

Afer mesnates ata i jane afruar piramides se kufirit, por jane diktuar nga ushtaret e sherbimit, te cilet kane qelluar ne drejtim te tyre. Te dy shkelesit e kufirit jane larguar me vrap e jane fshehur ne erresire.

Pas kesaj eshte dhene alarmi dhe forcat ushtarake kane kaluar ne ndjekje te tyre. Ne mengjes ata kane tentuar perseri te kalojne kufirin. I pandehuri Gezim Tafa ka pare viktimen qe po ecte me shpejtesi, ka qelluar drejt tij me bresheri automatiku dhe e ka lene te vrare ne vend. Nga ekzaminimet qe i jane bere viktimes ka rezultuar se atij i jane shkaktuar disa plage ne vende jetike si rezultat i plumbave qe jane shtire nga arma e te pandehurit me qitje te panderprere, te cilat i kane shkaktuar vdekje te menjehereshme.

Vepra eshte cilesuar vrasje me dashje ne baze te nenit 76 te K.Penal. Mbrojtesi i te pandehurit ka pretenduar se i pandehuri fillimisht eshte sulmuar me thike nga viktima, por te dy gjykatat kane pranuar qe i pandehuri me viktimen nuk kane qene ne distance te afert dhe se viktima nuk ka kryer asnje veprim ndaj te pandehurit, prandaj e kane rrezuar pretendimin per cilesimin e vepres si vrasje ne kapercim te kufinjve te mbrojtjes se nevojshme, parashikuar si krim nga neni 83 i Kodit Penal.

Persa i perket gjykimit te kesaj ceshtjeje, Kolegjet e Bashkuara cmojne se, para shqyrtimit te themelit te saj per t`u dhene pergjigje shkaqeve te parashtruara ne rekurs, eshte e domosdoshme te konkludohet paraprakisht ne se jane kushtet procedurale qe e bejne rekursin date 07.11.2001 te pranueshem per shqyrtim. Nepermjet ketij shqyrtimi praprak behet e mundur qe t`u jepet pergjigje edhe disa problemeve te shtruara per efekt te njesimit te praktikes gjyqesore.

1. Se pari, duhet te konkludohet se cila gjykate eshte kompetente per te shqyrtuar kerkesen per rivendosjen ne afat per te bere ankim kunder vendimit qe eshte dhene ne mungese.

Shumica eshte e mendimit se, ne kuptim te nenit 147 te K.Pr.Penale, kerkesa per rivendosje ne afat per te bere ankim behet ne gjykaten qe ka dhene vendimin dhe si e tille duhet kuptuar pergjithesisht gjykata e shkalles se pare (gjykata e rrethit gjyqesor perkates). Kjo rezulton nga permbajtja e pikave 5 e 6 te nenit 147 te K.Pr.Penale.

Sipas pikes 5, "Vendimi qe lejon rivendosjen ne afat per berjen e ankimit mund te ankimohet

vetem bashke me vendimin perfundimtar". Ndersa sipas pikes 6, "Kunder vendimit qe refuzon kerkesen per rivendosje ne afat mund te behet ankim ne gjykaten e Apelit".

Duke interpretuar ne teresi e ne lidhje me njera tjetren keto dy pika arrihet ne perfundimin se ankimi i vecante lejohet vetem kur gjykata e shkalles se pare refuzon rivendosjen ne afat te ankimit (sipas rastit, respektivisht, te apelit apo te rekursit).

Dispozita e mesiperme parashikon ne menyre te shprehur (eksplicite) se ankimi behet ne gjykaten e Apelit. Mirepo, neni 148/2 i K.Pr.Penale parashikon edhe mundesine qe rivendosja ne afat e ankimit te shqyrtohet nga Gjykata e Larte. Kjo nuk nenkupton te drejten e pales per t`i u drejtuar direkt Gjykates se Larte, por te drejten e saj per t`u ankuar ne Gjykaten e Larte kunder vendimit per mospranimin e kerkeses per rivendosjen ne afat te ankimit. Kuptohet qe ankimi, sipas nenit 147, pika 7, behet fillimisht ne Apel e mandej, ne rast refuzimi, perseritet ne Gjykaten e Larte. Ne rast se gjykata e Apelit e pranon kerkesen per rivendosje ne afat te ankimit, atehere i lind e drejta prokurorit qe te kundershtoje ne Gjykaten e Larte rivendosjen ne afat se bashku me vendimin perfundimtar te gjykates se apelit. Ne rastin kur nuk eshte pranuar kerkesa per rivendosjen ne afat te ankimit si nga gjykata e shkalles se pare, ashtu dhe nga gjykata e Apelit, dhe Gjykata e larte mbi bazen e ankimit qe i eshte paraqitur, konkludon se kjo kerkese duhej pranuar sepse kane qene kushtet per t`u pranuar, atehere kjo gjykate (Gjykata e Larte) vendos te ndryshoje vendimet e gjykatave me te ulta, te rivendose ne afatin e ankimit palen perkatese dhe t`ia dergoje ceshtjen gjykates kompetente per ta shqyrtuar ate ne themel.

Si perfundim, pavaresisht nese ceshtja eshte shqyrtuar ne themel apo jo edhe nga gjykata e Apelit, kompetente per te shqyrtuar kerkesen per rivendosjen e afatit te ankimit eshte gjykata e shkalles se pare. Gjykata e Apelit dhe, pas saj, Gjykata e Larte, shqyrtojne vetem ankimet kunder vendimeve respektive.

2. Nga analiza e mesiperme konkludohet se, per rastin ne shqyrtim gjykata e shkalles se pare e rrethit gjyqesor Kolonje ishte kompetente per te shqyrtuar kerkesen per rivendosjen e afatit te rekursit kunder vendimit te themelit te dhene nga gjykata e Apelit.

Kjo kerkese per rivendosjen ne afat eshte shqyrtuar nga nje gjyqtar i vetem.

Mirepo rezulton qe i pandehuri eshte denuar me 12 (dymbedhjete) – vjet heqje lirie per nje krim per te cilin dispozita perkatese parashikon nje denim maksimal me 20 (njezet) vjet heqje lirie.

Per rrjedhoje shtrohet pyetja: gjersa gjykimi i ceshtjes per akuzen ne fjale ne te dy gjykatat e faktit eshte bere me trupa gjykues te perbere nga tre gjyqtare, atehere a mund te pranohet qe kerkesa per rivendosjen ne afat te ankimit kunder vendimeve te dhena te shqyrtohet nga nje gjyqtar i vetem. Nje gje e tille do te ishte e pranueshem ne qofte se Kodi i Procedures Penale do ta parashikonte ate ne menyre te shprehur (eksplicite). Nje parashikim te tille nuk e hasim. Per me teper, edhe ndryshimi i nenit 13 te K.Pr.Penale me ligjin nr.8813, date 13.6.2002, mbeshtet menyren e arsyetmit si me siper. Dispozita ne fjale parashikon ne menyre taksative rastet kur ceshtjet gjykohen me nje gjyqtar te vetem dhe ne keto raste nuk perfshihet rasti ne fjale.

Pra gjykata e rrethit gjyqesor Kolonje ka gjykuar me nje gjyqtar te vetem nje kerkese qe, sipas ligjit, duhej te gjykohej me trup gjykues te perbere nga tre gjyqtare. Kjo perben qartesisht nje rast pavlefshmerie absolute te aktit (vendimit) ne kuptim te nenit 128 te K.Pr.Penale.

Sipas kesaj dispozite, "1.Aktet procedurale jane absolutisht te pavlefshme kur nuk respektohen dispozitat qe lidhen me:

a – Kushtet per te qene gjyqtar ne ceshtjen konkrete dhe numurin e gjyqtareve qe jane te domosdoshem per formimin e kolegjeve te caktuara ne kete kod; …….".

Nisur nga sa me lart, vendimi i gjyqtarit te vetem per rivendosjen e afatit te ankimit (rekursit) te te pandehurit te gjykuar ne mungese eshte akt absolutisht i pavlefshem dhe, si i tille, konsiderohet i paqene (nul).

Sipas nenit 128/2 te K.Pr.Penale, "2. Nje akt i cilesuar me ligj si absolutisht i pavlefshem nuk mund te behet i vlefshem".

Per rrjedhoje, pavlefshmeria absolute (nuliteti) i vendimit nr.1, date 29.10.2001 te gjykates se rrethit gjyqesor Kolonje, per rivendosjen e afatit te ushtrimit te rekursit ne emer te te pandehurit Gezim Tafa, e ben te papranueshem per shqyrtim edhe rekursin e paraqitur ne Gjykaten e Larte prandaj duhet te

vendoset pushimi i gjykimit ne kete gjykate. Ky vendim per pushimin e gjykimit nuk i a heq te drejten te pandehurit Gezim Tafa per te kerkuar ne te ardhmen, vete, ose nepermjet nje perfaqesuesi te tij te pajisur me prokure, rivendosjen ne afat per te bere ankim kunder vendimit penal te dhene ne mungese te tij, ne pajtim me kriteret e vendosura ne nenin 147/2 e 3 te K.Pr.Penale. Kerkesa per rivendosjen ne afat te ankimit shqyrtohet kurdohere me pjesemarrjen e mbrojtesit te te pandehurit dhe te prokurorit. Ky i fundit, ne rast se gjykata pranon rivendosjen ne afat te ankimit (rekursit), ka te drejte qe se bashku me kunderrekursin te paraqese edhe ankimin kunder vendimit qe ka pranuar rivendosjen ne afat per berjen e rekursit (neni 147/5 i K.Pr.Penale).

3. Rezulton se gjykimi si ne shkalle te pare edhe ne Apel eshte bere ne mungese te te pandehurit per shkak se ai eshte larguar dhe i fshihet gjykimit.

Sipas nenit 147/2 te K.Pr.Penale, "Ne qofte se eshte dhene vendimi ne mungese, i pandehuri mund te kerkoje rivendosjen ne afat per te bere ankim, kur provon se nuk ka marre dijeni per vendimin". Ndersa sipas paragrafit 3 te kesaj dispozite, "Kerkesa per rivendosjen ne afat paraqitet brenda 10 diteve … nga dita kur i pandehuri ka marre dijeni efektivisht per aktin".

Nga shqyrtimi i te dy paragrafeve te mesiperm konstatohet ne menyre eksplicite se subjekti qe mund te kerkoje rivendosjen ne afat per te bere ankim kunder vendimit te dhene ne mungese eshte vetem i pandehuri dhe se kjo kerkese per rivendosje ne afat ka nje afat 10 ditor per t`u paraqitur, i cili fillon nga momenti kur i pandehuri ka marre dijeni efektivisht per vendimin e dhene ne mungese te tij.

Praktikisht ky moment "i marrjes dijeni efektivisht" mund te percaktohet vetem nga i pandehuri, ose nga ndonje person tjeter qe mund te kete marre kontakt personalisht me te dhe qe mund te jete informuar prej tij. Ne pikpamje ligjore e drejta per te kerkuar apo jo rivendosjen ne afat per te bere ankim, ashtu si dhe vete e drejta e ankimit, eshte nje e drejte ngushtesisht personale e te pandehurit madhor. Kete te drejte ai mund t`ia delegoje me vullnetin e tij te lire nje mbrojtesi te caktuar prej tij nepermjet nje akti perfaqesimi te leshuar e te vertetuar ne formen e parashikuar ne ligj.

Ne kete rast, ne dispoziten e mesiperme, perdoret shprehja "kur provon", duke i u referuar personalisht te pandehurit. Duke u nisur nga ky percaktim rezulton se barra e proves per te provuar marrjen dijeni dhe per momentin e marrjes dijeni efektivisht per vendimin e dhene ne mungese i perket te pandehurit, pasi eshte ky ai ndaj te cilit ka nje vendim gjyqesor qe duhet ekzekutuar, por qe mund te ankohet ne qofte se vendimi nuk dihej prej ketij te fundit. Ne rastin konkret kemi te bejme me nje ekskluzivitet te te pandehurit, i cili mund te ushtroje vete te drejten per te kerkuar rivendosjen ne afatin e ankimit, ose nepermjet te autorizuarve posacerisht prej tij. Duke qene se ligji kerkon qe i pandehuri te provoje mospasjen dijeni per vendimin, askush tjeter nuk mund ta zevendesoje ate per te njejtin shkak, perfshi ketu edhe familjaret. Pranimi i te kundertes nuk do ishte vetem ne kundershtim me sa parashikon neni 147/2, por do te ishte sa allogjik aq edhe ne kundershtim me interesat e vete te pandehurit. Ne qofte se do te pranohej e kunderta do te krijohej situata qe te pranohej apriori i mireqene fakti qe i pandehuri te ishte ne dijeni te nje vendimi, kur nuk e dinte realisht ate. Nderkohe duke u konsumuar e drejta qe parashikon neni 147/2 i K.Pr.Penale nga mbrojtesi i caktuar kryesisht, ose familjaret e tij, do t`i mohohej padrejtesisht e drejta vete te pandehurit per te kerkuar rivendosjen ne afat te ankimit. Sipas nenit 147/3 te K.Pr.Penale, " … Rivendosja ne afat nuk lejohet me shume se nje here per sejcilen pale per cdo shkalle te procedimit".

Megjithate, edhe sikur te pranohej e kunderta, d.m.th. qe mbrojtesi i caktuar kryesisht apo nga familjaret e te pandehurit, te kete te drejte te beje kerkese per rivendosje ne afat te ankimit (apelit apo rekursit) dhe mandej te beje ankimin kunder vendimit ne emer e per llogari te te pandehurit, perseri lind nje problem qe duhet sqaruar: Ne rastin konkret, personi qe ka bere kerkesen per rivendosje ne afat te ankimit dhe qe me vone ka bere rekursin ne Gjykaten e Larte, a e ka marre proceduralisht cilesine e mbrojtesit te caktuar kryesisht nga organi procedues, gjykata, apo te caktuar nga te afermit e te pandehurit?

Kjo cilesi konfirmohet dhe pranohet nga organi procedues, prokuroria apo gjykata, gjate hetimit paraprak apo gjate gjykimit te ceshtjes dhe jo ne rruge ekstra procedurale. Si perfundim, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte verejne se nje person qe nuk eshte legjitimuar si mbrojtes i caktuar kryesish apo nga familjaret e te pandehurit, gjate procedimit te ceshtjes ne hetimin paraprak apo gjate

gjykimit, nuk mund ta fitoje kete cilesi ne rruge ekstra procedurale.

Sa me lart eshte edhe nje argument me shume ne favor te perfundimit qe, ne rastin e gjykimit te ceshtjes ne mungese te te pandehurit per shkak se ky i fshihet gjykimit, te drejten per te kerkuar rivendosjen ne afat te ankimit dhe te drejten per te bere ankim kunder vendimit ne nje gjykate me te larte e ka vetem i pandehuri, ose nje mbrojtes i caktuar prej tij me prokure.

Ky qendrim konfirmohet edhe prej plotesimit qe i behet nenit 410/2 te K.Pr.Penale me hyrjen ne fuqi te Ligjit nr.8813 date 13.6.2002 "Per disa shtesa e ndryshime ne ligjin nr.7905, date 21.03.1995 "Kodi i Procedures Penale i Republikes se Shqiperise". Konkretisht, ligjvenesi dispoziten e sipercituar e ka riformuluar si me poshte: " …2.Kunder vendimit te dhene ne mungese, mbrojtesi mund te beje ankim vetem kur eshte i pajisur me nje akt – perfaqesimi te leshuar nga i pandehuri ne format e parashikuara nga ligji".

PER KETO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, ne baze te neneve 438, 441/c dhe 442/b te K.Pr.Penale, dhe te nenit 17 te Ligjit nr.8588, date 15.3.2000 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykates se Larte te Republikes se Shqiperise",

V E N D O S E N:

1. Prishjen e vendimit nr.1, date 29.10.2001 te gjykates se rrethit gjyqesor Kolonje me te cilin eshte pranuar rivendosja ne afat e te pandehurit (te gjykuarit) Gezim Tafa per te ushtruar rekurs ne gjykaten e Larte kunder vendimit nr.610, date 16.08.1996 te gjykates se Apelit Tirane.
2. Pushimin e gjykimit te rekursit ne Gjykaten e Larte.
3. Ky vendim per njesimin e praktikes gjyqesore te dergohet per botim ne Fletoren Zyrtare.

MENDIM PARALEL

Jemi dakord me zgjidhjen e ceshtjes nga shumica, duke e konsideruar te papranueshem per shqyrtim ne Gjykaten e Larte rekursin e te pandehurit Gezim Tafa kunder vendimit nr.610, date 16.08.1996 te Gjykates se Apelit Tirane.

Nuk jemi plotesisht dakord me menyren e arsyetimit te vendimit nga shumica, me disa argumenta te parashtruara e konkluzione te nxjerra prej saj.

Shumica ka pranuar se, pavaresisht ne se ceshtja eshte shqyrtuar ne themel apo jo edhe nga gjykata e Apelit, kompetente per te shqyrtuar kerkesen per rivendosjen e afatit te ankimit eshte gjykata e shkalles se pare.

Ne kundershtim me sa me lart, pakica eshte e mendimit qe, ne cdo rast, kompetente per te shqyrtuar kerkesen per rivendosjen e afatit te ankimit kunder nje vendimi gjyqesor eshte ajo gjykate qe ka dhene vendimin qe kerkohet te ankimohet. Ne qofte se do te kerkohet te rivendoset e drejta e ushtrimit te apelit kunder nje vendimi te gjykates se shkalles se pare, atehere kompetente per te shqyrtuar kerkesen eshte kjo gjykate qe ka dhene vendimin. Ne qofte se, si ne rastin ne shqyrtim, do te kerkohet te rivendoset e drejta e ushtrimit te rekursit kunder vendimit te gjykates se Apelit, atehere i takon kesaj gjykate te marre ne shqyrtim kete kerkese.

Si perfundim, vendimi nr.1, date 29.10.2001 i Gjykates se Rrethit Kolonje, qe ka vendosur rivendosjen ne afat te se drejtes se ushtrimit te rekursit ne emer te te gjykuarit Gezim Tafa, eshte i pavlefshem per shkaqet qe pranon shumica, por edhe sikur te mos ishin ato shkaqe pavlefshmerie, ky vendim eshte marre ne kundershtim me ligjin, sepse gjykata e rrethit Kolonje ka marre kompetencen funksionale te nje gjykate me te larte sic eshte gjykata e Apelit.

Shumica e ka bazuar perfundimin qe ka nxjerre per kete problem nisur nga formulimi i pikes "6 " te nenit 147 te K.Pr.Penale, sipas te ciles, "… 6. Kunder vendimit qe refuzon kerkesen per rivendosje ne

afat mund te behet ankim ne gjykaten e apelit".

Permendja e gjykates se Apelit si gjykate qe shqyrton ankimin ne kete rast, nuk do te thote se te gjitha kerkesat per rivendosje ne afat te ankimit (apelit apo rekursit) duhet t`i adresohen detyrimisht gjykates se shkalles se pare.

Kjo do te thote se gjykata e shkalles se pare eshte kompetente per te shqyrtuar kerkesen per rivendosjen ne afat te ankimit (apelit) dhe kur pranohet kerkesa behet ankimi ne Apel kunder vendimit te dhene ne shkalle te pare. Por, kjo nuk do te thote apriori se gjykata e shkalles se pare behet kompetente edhe per te shqyrtuar kerkesen per rivendosjen e afatit te ankimit (rekursit) kunder vendimit te gjykates se apelit. Po te pranohej kjo nuk do te kishte kuptim formulimi i pikes 4 te nenit 147 te K.Pr.Penale. Sipas kesaj dispozite,

" …4.Per kerkesen eper rivendosjen ne afat te ankimit] vendos organi qe procedon ne kohen e paraqitjes se saj."

Ne rastin ne shqyrtim, ne kuptim te dispozites se sipercituar, organi qe procedon ne kohen e paraqitjes se kerkeses eshte gjykata e apelit, vendimi i se ciles eshte i formes se prere, por qe mund te atakohet me ane rekursi ne Gjykaten e Larte.

Pakica eshte e mendimit qe, edhe sikur te mos ekzistonin shkaqet qe e bejne absolutisht te pavlefshem vendimin nr.1, date 29.10.2001 te gjykates se rrethit gjyqesor Kolonje, ligjshmeria e ketij vendimi do te ishte objekt shqyrtimi paraprak prej Gjykates se Larte.

Mund te arsyetohet qe ky vendim eshte i formes se prere dhe, si i tille, ai nuk mund te cenohet per cfaredo lloj shkaku, pervec nulitetit. Pakica ka mendim te kundert. Vendimi qe lejon rivendosjen ne afat nuk eshte vendim themeli. Si i tille ai nuk eshte nga ato vendime qe marrin forme te prere ne kuptimin substancial. Ato mund te shqyrtohen ne shkallet me te larta te gjykimit, kur eshte rasti edhe kryesisht, se bashku me vendimin e themelit te atakuar me apel apo rekurs.

Sipas nenit 434 te K.Pr.Penale, "Gjykata e Larte e shqyrton ceshtjen brenda kufinjve te shkaqeve te ngritura. Por per ceshtjet ligjore, qe duhet te shihen kryesisht nga gjykata ne cdo gjendje e shkalle te procesit, te cilat nuk jane pare, gjykata e Larte ka te drejte te vendose".

Ky qendrim eshte ne nje linje me vendimin unifikues te Kolegjeve te Bashkuara nr.2, date 19.4.2001, qe u perket te pandehurve Altin Luzi, etj.

GJYQTARËT:
N. SHESHIP. ZAHARIATH. KONDI

MENDIMI I PAKICES

Pakica eshte dakord me perfundimet e arritura nga shumica lidhur me unifikimin e praktikes gjyqesore. Ajo ka mendimin se kerkesa per rivendosjen ne afat te ankimit ashtu sikurse pranuar nga shumica, duhet te shqyrtohet nga gjykata e shkalles se pare ne te cilen eshte dhene vendimi gjyqesor per te cilin kerkohet rivendosje ne afat te ankimit.

Pakica, gjithashtu eshte dakort edhe me perfundimin se te drejten per te kerkuar rivendosjen ne afat per te bere ankim, ne kuptim te nenit 147/2 te K.Pr.P. e ka personi qe eshte gjykuar ne mungese i cili mund ta kerkoje kete vete, ose nepermjet perfaqesuesit te tij te posacem. Askush tjeter pervec te gjykuarit ne mungese nuk mund te legjitimohet qe te kerkoje rivendosjen ne afat per te bere ankim ndaj vendimit te dhene ne mungese te tij, qofshin keta edhe familjare te tij. Kjo, per faktin se dispozita perkatese e K.Pr.P e lidh ne menyre te shprehur rivendosjen ne afat me vete te gjykuarin, me kushtin qe ai duhet te provoje se nuk ka marre dijeni per vendimin e dhene ne mungese. Pranimi i te kundertes, do t'i mohonte te drejten te gjykuarit ne mungese qe te kerkonte rivendosjen ne afatin e ankimit per shkak se te tretet e kane ushtruar te drejten e tij, pa dijenine e vete te gjykuarit. Kjo do ta bente procesin e parregullt dhe ne kundershtim jo vetem me kerkesat e nenit 147/2 te K.Pr.P., por edhe me te drejten e te pandehurit per t'u mbrojtur ndaj nje vendimi gjyqesor kur ai provon se vendimi eshte dhene ne mungese, dhe jo per faj te tij.

Pavaresisht nga sa pranohet, pakica ka votuar kunder menyres se zgjidhjes se ceshtjes naa

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte qe kane konstatuar shkelje ligjore ne proceduren e rivendosjes ne afat te ankimit dhe kane prishur vendimin e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kolonje Nr.1, date 29.10.2001, qe ka pranuar kerkesen. Mendojme se Kolegjet e Bashkuara, megjithese ne themel kane pasur te drejte lidhur me kunderligjshmerine e ketij vendimi, ato kane dale jashte objektit te shqyrtimit te ceshtjes ne Gjykaten e Larte, pasi ai vendim nuk ka qene objekt i kundershtimit ne kete gjykate. Ajo ka patur per shqyrtim rekursin kunder vendimit te denimit Nr. 12, date 19.6.1996, te Gjykates se Rrethit Kolonje i cill eshte lene ne fuqi nga vendimi Nr.610, date 16.8.1996 i Gjykates se Apelit. Kunder vendimit Nr.1, date 29.10.2001, per te cilin jane shprehur Kolegjet e Bashkuara nuk ka bere askush ankim dhe ky vendim nuk eshte kontestuar Ildhur me bazueshmerine e tij nga organi i akuzes. Ne te kundert, organi i prokurorise, ne seance gjyqesore ne Kolegjet e Bashkuara, ne kerkimet e tij dhe ne argumentat e paraqitura me shkrim e me goje, jo vetem qe nuk e ka kundershtuar kete vendim, por duke e konsideruar te mireqene ate, i ka kerkuar Kolegjeve te Bashkuara qe te gjykoje shkaqet e ngritura ne rekurs dhe ta pranoje ate, duke ndryshuar cilesimin juridik te vepres sikurse eshte kerkuar, e per pasoje, te pushoje ceshtjen pasi duhet te aplikohet ligji per amnistine, Nr.8202, date 27.3.1997.

Ne mbeshtetje te qendrimit te saj, pakica mendon se Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, ashtu si cdo gjykate tjeter, vihet ne levizje nga palet ne proces dhe ju pergjigjet kerkesave te tyre. Kolegjet e Bashkuara si gjykate me e larte nuk mund te marre ceshtje me inisiative per te shqyrtuar, po ashtu nuk mund te disponoje per vendime te dhena nga gjykatat me te ulta, pa patur ankim nga palet ne proces. Neni 434 i K.Pr.P. parashikon se Gjykata e Larte e shqyrton ceshtjen brenda kufijve dhe shkaqeve te ngritura. Megjlthate, ne dallim nga procedura civile, ne procesin penal, kesaj gjykate i jepet e drejta, qe per ceshtje te ligjit te vendose edhe kryesisht, pavaresisht se ato nuk jane ngritur si shkaqe nga palet. Kjo do kuptuar, se per ceshtje te cilat duhej te shiheshin kryesisht nga gjykatat e tjera dhe qe kane te bejne me aplikimin e gabuar te ligjit, edhe pse keto nuk jane ngritur ne rekurs, Gjykata e Larte mund t'i konstatoje kryesisht dhe te disponoje ne vendimin e saj. Ne kete drejtim, Kolegji Penal i Gjykates se Larte ka patur mjaft raste te konstatimit te pavlefshmerive kryesisht, duke zbatuar kerkesat e nenit 434 te K.Pr.P., pavaresisht se ato nuk kane qene bere prezent nga palet dhe ne kuptim te nenit 128 te K.Pr.P., ka cenuar vendimet e marra ne shkelje te ligjit. Raste te kesaj natyre, me te shumta ne numur, kane qene ato qe kane pasur te bejne me sigurimin e pjesemarrjes se te pandehurit ne gjykimin ne gjykaten e apelit, apo raste te tjera pavlefshmerie te parashikuara nga neni 128 i K.Pr.P.

Pavaresisht nga kjo, neni 434 i K.Pr.P., duhet kuptuar me ate qe gjykata konstaton shkelje te ligjit te cilat nuk jane ngritur ne ankimin e bere kunder vendimit gjyqesor nga palet. Pra, ndaj vendimit eshte ushtruar ankim, por shkaqet per cenimin e tij, jane te ndryshme nga ato te ngritura ne rekurs. Kjo do te thote se ne kuptim te nenit 434 te K.Pr.P. kur ushtrohet rekurs vetem ndaj vendimit, do te legjitimohej Gjykata e Larte qe te cenoje vendimin per shkaqet e ngritura e te tjera te konstatuara prej saj dhe te pangritura. Ne rastin ne fjale nuk ka ankim ndaj vendimit Nr.1, date 29.10.2001 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kolonje, por ka ankim ndaj vendimit Nr.610, date 16.8.1996, te Gjykates se Apelit Tirane dhe Nr.12, date 19.6.1996 te Gjykates se Rrethit Kolonje, te cilet e kane deklaruar fajtor te gjykuarin Gezim Tafa per vepren penale te parashikuar nga neni 76 i K.P. dhe e kane denuar ate me 12 vjet burgim.

Pra, gjykata nuk e ka patur objekt te gjykimit vete vendimin e rivendosjes ne afatin e ankimit, pasi askush nuk e ka ankimuar ate. Duke qene ne keto kushte, pakica ka mendimin se Kolegjet e Bashkuara kane vleresuar ligjshmerine e nje vendimi gjyqesor te pa ankimuar ne Gjykaten e Larte duke dale tej caqeve qe lejon ligji.

GJYQTARËT:
V. METANI, A. HOXHA, K. NGJELA,V. BINERI,
E. SINOIMERI, A. LAMAJ

V E N D I M
Nr. 4, date, 14.10.2002

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte te perbere nga:

Thimjo KondiKryesues
Perikli ZahariaAnetar
Kristaq Ngjela “
Ylvi Myrtja “
Spiro Spiro “
Bashkim Caka “
Nikoleta Kita “
Agron Lamaj “
Natasha Sheshi “
Artan Hoxha “
Metush Saraçi “
Valentina Kondili “
Vladimir Metani “
Vladimir Bineri “
Zamir Poda “
Evgjeni Sinoimeri “
Irma Bala ”

ne seancen gjyqesore te dates 10.10.2002 dhe 14.10.2002 moren ne shqyrtim ceshtjen penale nr. 6 qe i perket:

TE PANDEHURIT: PELLUMB DYRMISHI, i biri Selimit dhe Aishes, i datelindjes 1965, lindur ne Cerrik-Elbasan dhe banues ne lagjen Nr.13-Durres.

I AKUZUAR: Per kryerjen e vepres penale te vrasjes me dashje ne bashkepunim, parashikuar nga nenet 76 e 25 te K.Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Elbasan, me vendim nr. 95 date 13.9.2000, ka vendosur:

“Deklarimin fajtor te te pandehurit Pellumb Dyrmishi per kryerjen e vepres penale te vrasjes me dashje ne bashkepunim ne dem te shtetasit Gentian Popa, parashikuar nga nenet 76 e 25 te Kodit Penal e po ne baze te ketyre neneve e denon ate me 13 vjet burgim.

Vuajtja e denimit fillon nga data 7.10.1999, qe eshte data e ndalimit te tij”.

Gjykata e Apelit Durres, mbi apelin e te pandehurit, me vendim nr. 230 date 8.11.2000, ka vendosur:

“Prishjen e vendimit nr. 95 date 13.9.2000 te Gjykates se Rrethit Elbasan dhe pushimin e ceshtjes penale ne ngarkim te te pandehurit Pellumb Dyrmishi, per akuzen e vrasjes ndaj shtetasit Gentian Popa”.

Kunder vendimit te Gjykates se Apelit Durres dhe vendimit te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Elbasan, ka paraqitur rekurs, ne baze te nenit 432 te K.Pr.Penale, Prokurori i Pergjithshem i Republikes, i cili kerkon prishjen e tyre dhe kthimin e ceshtjes per rigjykim, duke parashtruar keto shkaqe:

- Vendimet e gjykatave jane te pabazuara ne ligj dhe ne prova, pasi:

1. Jane kryer veprime hetimore nga oficere te policise gjyqesore pa urdher delegimi, sipas kritereve te nenit 304/2 te K.Pr.Penale.

2. Eshte pushuar akuza ne ngarkim te te pandehurit Genci Duzha, kur ndaj tij nuk ishte ngritur akuze.

3. Jane kryer veprime hetimore jashte afatit ligjor dhe sipas kritereve te nenit 324/4 dhe 128/2 te K.Pr.Penale ato jane absolutisht te pavlefshme dhe nuk mund te perdoren.

- Nga ana e Gjykates se Apelit Durres eshte gabuar ne menyren e argumentimit te pushimit te ceshtjes se, Prokurori i Pergjithshem i Republikes nuk e ka patur te drejten e shfuqizimit te vendimit te pushimit dhe, meqenese, per keto raste, jane mbajtur qendrime te ndryshme, Gjykata e Larte duhet te unifikoje praktiken lidhur me vendimet e shfuqizuara nga Prokurori i Pergjithshem i Republikes, sipas kritereve te nenit 141/2 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise.

- Kryetari i Gjykates se Larte, me vendim date 15.5.2002, ka vendosur: “Terheqjen nga Kolegji Penal te ceshtjes penale me nr. akti 374, date 18.4.2002, qe i perket te pandehurit Pellumb Dyrmishi dhe kalimin e saj per shqyrtim ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte”, me arsyetimin “per te sheshuar kundertite e lindura ndermjet vendimeve te kolegjeve te vecanta” dhe pikerisht me interpretimet e bera nga ato lidhur me nenin 24/4 te K.Pr.Penale - “Funksionet e prokurorit”.

KOLEGJET E BASHKUARA TE GJYKATES SE LARTE,

pasi degjuan relatimin e ceshtjes nga anetaret Kristaq Ngjela dhe Ylvi Myrtja, prokurorin Saliko

Hajno, qe kerkoi prishjen e vendimit te Gjykates se Apelit Durres e te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Elbasan e dergimin e ceshtjes per rishqyrtim gjykates se rrethit e si analizuan ceshtjen ne teresi,

V E R E J N E:

I pandehuri Pellumb Dyrmishi eshte derguar per gjykim per akuzen e vepres penale te vrasjes me dashje te kryer ne bashkepunim parashikuar nga neni 76 e 25 i Kodit Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Elbasan, pasi ka administruar provat ne gjykimin e ceshtjes, ka arritur ne perfundimin se Pellumb Dyrmishi, e ka kryer vepren per te cilen akuzohet dhe me vendimin nr. 95 date 13.9.2000, ka vendosur deklarimin e tij fajtor per vrasjen me dashje te viktimes Gentjan Popa ne bashkepunim dhe denimin me 13 (trembedhjete) vjet burgim.

Ne vendimin e marre, ajo gjykate pranon se:

I pandehuri Pellumb Dyrmishi ka emigruar ne Greqi bashke me familjen, vellane Kujtim, Myrteza (Zani) Caushi, Genc Duzho, Arben Eqimi, etj. ku me pas ka shkuar edhe viktima Gentjan Popa. Ky i fundit, me daten 8.2.1995, eshte gjetur i djegur ne Pire, gje qe eshte percaktuar se kufoma ishte e tij ne baze te analizave te ADN-se. Duke analizuar provat e marra, gjykata e rrethit ka arritur ne perfundimin se vrasjen e Gentjan Popes e ka kryer i pandehuri Pellumb Dyrmishi per shkak te nje grindje qe kishte patur me te me daten 5.2.1995 ne bashkepunim me shtetasin Genci Duzho.

Gjykata e Apelit Durres, me vendimin nr. 230 date 8.11.2000 ka vendosur prishjen e vendimit te Gjykates se Rrethit Elbasan dhe pushimin e ceshtjes penale ne ngarkim te te pandehurit Pellumb Dyrmishi per akuzen e vrasjes se shtetasit Gentjan Popa. Vendimin e saj kjo gjykate e mbeshtet ne faktin se, me vendim te prokurorit date 25.4.1997, eshte pushuar ceshtja penale ne ngarkim te te pandehurit Pellumb Dyrmishi per mungese provash dhe se me urdherin nr. 17 date 1.3.1999, Prokurori i Pergjithshem ka anulluar vendimin e pushimit, veprim ky qe (sipas vendimit te gjykates se apelit) eshte i pabazuar ne ligj pasi Prokurori i Pergjithshem nuk e ka patur te drejten e shfuqizimit te vendimeve e se vendimi i pushimit, mund te shfuqizohet vetem nga gjykata e shkalles se pare ne perputhje me kerkesat e nenit 329 te K.Pr.Penale (ankimi kunder vendimit te pushimit te ceshtjes).

Per te mbeshtetur vendimin e saj, Gjykata e Apelit Durres permend edhe qendrimin e mbajtur nga Kolegji Penal i Gjykates se Larte me vendimin nr. 270 date 4.9.2000. Ne kete vendim te Kolegjit Penal te Gjykates se Larte eshte pranuar se, vendimi i marre nga nje prokuror prane Prokurorise se Pergjithshme per shfuqizimin e vendimit te pushimit te ceshtjes marre nga prokurori, ishte ne kundershtim me kerkesat ligjore, se ai vendim nuk mund te sjelle pasoja juridike pasi prokurori prane Prokurorise se Pergjithshme, nuk kishte te drejten e shfuqizimit te vendimit te pushimit te ceshtjes sepse sipas nenit 24/4 te K.Pr.Penale “urdherat dhe udhezimet e prokurorit me te larte jane te detyrueshme per prokurorin me te ulet” e per pasoje, prokurori me i larte, nuk ka te drejte te marre vendime por vepron ne realizim te funksioneve te tij vetem me urdhera dhe udhezime.

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte e shohin te arsyeshme, qe problemet qe trajtohen ne vendimin e Gjykates se Apelit Durres e ne rekursin e Prokurorit te Pergjithshem te trajtohen hollesisht per te unifikuar praktiken gjyqesore lidhur me zbatimin e nenit 24/4 te K.Pr.Penale e per te menjanuar qendrimet e ndryshme qe jane per kuptimin e zbatimin e atij neni para shteses se bere ne piken 5 me ligjin nr. 8460 date 11.2.1992 sipas te cilit “Prokurori me i larte ka te drejte te vendose ndryshimin ose shfuqizimin e vendimeve te marra nga prokurori me i ulet”. Verehet se ne praktiken e gjykatave te rretheve, apeleve dhe te Kolegjit Penal te Gjykates se Larte ka qendrime te ndryshme ne keto drejtime:

a. si duhet kuptuar e drejta e prokurorit parashikuar ne piken 4 te nenit 24 te K.Pr.Penale. Me leshimin e urdherave dhe udhezimeve a ka te drejte prokurori me i larte te vendose per shfuqizimin e vendimeve te prokurorit me te ulet dhe

b. si duhet kuptuar ne veprimtarine praktike percaktimi qe behet ne piken 4 e 5 te nenit 24 te K.Pr.Penale “prokurori me i larte”.

Ne praktiken gjyqesore ka mjaft vendime qe lidhen me problemet e siperme dhe ne disa raste eshte pranuar se prokurori me i larte ka te drejte te vendose per shfuqizimin e vendimeve te prokurorit me

te ulet, ne disa raste se nuk ka kete te drejte si dhe ka patur diskutime e mendime te ndryshme se c'duhet kuptuar me prokuror me i larte dhe ne se te drejten e shfuqizimit e ka Prokurori i Pergjithshem apo edhe prokuroret e tjere prane Prokurorise se Pergjithshme.

Edhe ne vendimet e Kolegjit Penal te Gjykates se Larte verehen qendrime me te cilat eshte pranuar i ligjshem shfuqizimi i vendimeve ne baze te nenit 24/4 te K.Pr.Penale (permendim ketu vendimet nr. 238 date 11.7.2000, nr. 669 date 21.11.2001) apo vendime qe nuk pranojne veprimin e mesiperm te prokurorit (si vendimi nr. 259 date 29.6.1999, nr. 518 date 3.10.2001 etj.). Ndersa lidhur me prokurorin me te larte, ky kolegj, ka pranuar gjithmone se si i tille do te pranohet vetem Prokurori i Pergjithshem apo prokurore te autorizuar prej tij, pavaresisht nga praktikat e gjykatave te rretheve e apeleve.

Per qendrimin qe duhet mbajtur per problemet e siperme eshte e nevojshme qe t'i referohemi Kushtetutes se Republikes se Shqiperise. Ne baze te nenit 148 te se ciles "Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe perfaqeson akuzen ne gjyq… Prokuroret jane te organizuar dhe funksionojne prane sistemit gjyqesor si nje organ i centralizuar"; nenit 24 te K.Pr.Penale sipas te cilit "Prokurori ushtron ndjekjen penale, ben hetime, kontrollon hetimin paraprak, ngre akuze ne gjykate dhe merr masa per ekzekutimin e vendimeve ne perputhje me rregullat e caktuara ne kete kod"; si dhe ligjit nr. 8737 date 12.2.2001 "Per organizimin dhe funksionimin e Prokurorise ne Republiken e Shqiperise" ku pervec objektit te veprimtarise se Prokurorise eshte percaktuar struktura e funksionet kryesore dhe struktura e saj prane sistemit gjyqesor.

Funksionet e prokurorit, ushtrohen ne baze te kompetences lendore e territoriale te gjykates prane se ciles ai vepron dhe kjo eshte shprehur edhe ne K.Pr.Penale, i cili konkretizon si organizimin e prokurorise ne te gjitha nivelet ashtu edhe marredheniet e vartesise midis tyre. Ne baze te dispozitave te lartpermendura, ne K.Pr.Penale jane detajuar funksionet e prokurorit ne nenin 24, ne piken 4 te te cilit percaktohet se "urdherat e udhezimet e prokurorit me te larte jane te detyrueshme per prokurorin me te ulet".

Ne Kodin e Procedures Penale, (neni 328) parashikohen rastet kur prokurori vendos pushimin e ceshtjes penale, por eshte e kuptueshme qe keto vendime nuk mund te qendrojne larg kontrollit te prokurorit me te larte. Problemi shtrohet lidhur me termat qe perdoren ne nenin 24/4 te K.Pr.Penale, per mjetin qe perdor prokurori me i larte per te rivene ne levizje nje ceshtje penale te pushuar ne kundershtim me kerkesat ligjore. Kjo perben anen formale te ceshtjes ne se do te veprohet me urdher apo vendim dhe nuk ka te beje me themelin. (Ketu duhet permendur fakti se me shtesen e pikes 5 te nenit 24 u qartesua ky problem duke u shprehur "prokurori me i larte, ka te drejte te vendose…"). Termat urdher, udhezim, vendim, jane te ndryshme e s'ka precizim te tyre, por gjithashtu ne K.Pr.Penale nuk ka te percaktuara rastet se cilat veprime te prokurorit realizohen me urdher, cilat me udhezim e cilat me vendim. Por ne se i referohemi nenit 305 te K.Pr.Penale, ndeshemi ne nje kuptim qe duhet pranuar edhe per problemin ne shqyrtim. Ne kete nen thuhet "Prokurori i Pergjithshem, mbi ankesen e te pandehurit, te demtuarit ose edhe kryesisht, urdheron, me vendim te arsyetuar…" dhe duke ju referuar pikave 4 e 5 te nenit 24 te K.Pr.Penale, nuk mund te pranohet se ka inkoseguenca ne ligj. Prokurori me i larte ushtron ne cdo kohe kontroll mbi veprimtarine e prokuroreve te tjere (me te ulet) e per rrjedhoje, ne rast se konstaton nje vendim te pushimit te ceshtjes penale te marre ne kundershtim me kerkesat ligjore, ka te drejte te vendose per shfuqizimin e tij. Prokurori me i larte, ne zbatim te kompetences qe i jep neni 24/4 qe urdherat dhe udhezimet e tij jane te detyrueshme per prokurorin me te ulet, disponon mbi aktet e ketij te fundit gje qe behet me nje akt procedurial e nuk mund te pranohet se behet verbalisht. Ne kete aspekt, vendimi i prokurorit me te larte per shfuqizimin e nje vendimi te marre nga nje prokuror tjeter per pushimin e ceshtjes penale, perben ne vetvete nje urdher ne zbatim te nenit 24/4 te K.Pr.Penale.

Nga sa me siper, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, arrijne ne perfundimin se veprimtaria e Prokurorit te Pergjithshem per shfuqizimin e vendimeve te marra nga prokuroret e tjere, qofte edhe per pushimin e ceshtjes penale, eshte e ligjshme e ne ushtrim te kompetences qe i jep K.Pr.Penale. Ne keto rrethana, konkluzioni i arritur nga Gjykata e Apelit Durres se Prokurori i Pergjithshem ka vendosur per rastin ne shqyrtim ne kundershtim me kerkesat e ligjit duke shfuqizuar vendimin e pushimit e se ai nuk mund te sjelle pasoja juridike, eshte i gabuar.

I pabazuar ne ligj, eshte edhe perfundimi tjeter i Gjykates se Apelit Durres se vendimi i pushimit

te ceshtjes penale mund te shfuqizohet vetem nga gjykata e shkalles se pare ne zbatim te kerkesave te nenit 329 te K.Pr.Penale. Sipas ketij neni "kunder vendimit te pushimit te ceshtjes mund te bejne ankim ne gjykaten e rrethit i demtuari dhe i pandehuri". Sikurse shihet ne kete nen nuk i njihet e drejta prokurorit per te bere ankim kunder vendimit te pushimit te ceshtjes penale pasi prokurori me i larte nuk e con ceshtjen ne gjykate sepse kjo ka te beje me atributet e tij dhe e zgjidh vete nepermjet reagimit qe ben. Ne se do te pranohej e kunderta, atehere do te cenohej parimi i barazise se paleve ne procesin penal duke i mohuar prokurorit nje te drejte qe i njihet te pandehurit.

Duke patur parasysh realizimin e kompetencave te tij dhe mjetet qe duhet te perdore, Prokurori i Pergjithshem, me daten 1.3.1999, me urdherin nr. 17, ka urdheruar anullimin e vendimit te pushimit te ceshtjes ne ngarkim te te pandehurve Pellumb Dyrmishi e Genci Duzha dhe vazhdimin e metejshem te hetimeve, akt ky i ligjshem e ne perputhje me nenin 24/4 te K.Pr.Penale vleresim ky qe e ben te cenueshem vendimin e Gjykates se Apelit Durres.

Megjithese shtesa e pikes 5 te nenit 24 te K.Pr.Penale e qartesoi me tej te drejten e prokurorit me te larte qe te vendose per ndryshimin ose shfuqizimin e vendimeve te marra nga prokurori me i ulet, duhet pranuar se ne thelb kjo nuk solli ndryshime ne kompetencat e prokurorit e nuk mund te mbahet qendrim i kundert per piken 4 te nenit 24 te K.Pr.Penale nga ajo e percaktuar ne piken 5.

Problemi se kush duhet konsideruar prokuror me i larte gjen zgjidhje gjithashtu duke ju referuar dispozitave kushtetuese, te K.Pr.Penale e ligjit "Per organizimin dhe funksionimin e Prokurorise".

Sipas nenit 148/2 te Kushtetutes se Republikes te Shqiperise "prokuroret jane te organizuar dhe funksionojne prane sistemit gjyqesor si nje organ i centralizuar". Ndersa ne nenet 13, 14, 15 te ligjit nr. 8737 date 12.2.2001 "Per organizimin dhe funksionimin e Prokurorise ne Republiken e Shqiperise" percaktohet struktura e prokurorise prane sistemit gjyqesor ne prokurore prane Gjykates se Larte, funksione qe ushtrohen nga prokuroret e Prokurorise se Pergjithshme, prokurore prane gjykatave te apelit, funksione qe ushtrohen nga prokuroret e apelit dhe funksionet e prokurorise prane cdo gjykate te shkalles se pare ushtrohen nga prokuroret e shkalles se pare.

Edhe ne K.Pr.Penale jepen percaktimet per ushtrimin e funksioneve te prokurorit duke u shprehur se ne hetimet paraprake dhe ne gjykimet e shkalles se pare ato ushtrohen nga prokuroret prane gjykates se shkalles se pare, ne gjykimin e ceshtjeve te ankimuara, nga prokuroret prane gjykatave te apelit dhe prane Gjykates se Larte (neni 25 germat "a", "b"). Ne piken 2 te ketij neni thuhet: "Prokurori me i larte ka te drejte te ushtroje kompetencat e prokurorit me te ulet".

Ne kuptim te percaktimeve te dhena, duke patur parasysh se prokuroria eshte organ i centralizuar, ne prokurorite prane gjykatave te shkalles se pare prokuror me i larte, eshte prokurori i rrethit. Prokurori prane gjykates se apelit eshte prokuror me i larte ne raport me ate prane gjykates se rrethit gjyqesor vetem persa i perket gjykimit te ceshtjeve. Jo pa qellim ligjvenesi prokurorine e ka organizuar prane gjykatave duke percaktuar dhe funksionet e tyre. Me fjale te tjera, prokurori prane gjykates se apelit eshte prokuror me i larte ne kuptim te pozites dhe qendrimin qe mban lidhur me gjykimin e ceshtjeve penale ne raport me ate qe ka mbajtur prokuroria prane gjykates se rrethit gjyqesor. Nga ana tjeter kjo nuk i jep atij kompetenca apo autoritetin me te larte gjate fazes se hetimit paraprak dhe gjate gjykimit te ceshtjes ne Gjykaten e rrethit gjyqesor. Prokuror me i larte edhe ne rastet e shfuqizimit ose ndryshimit te vendimeve te pushimit te ceshtjeve penale (jo per rastet kur prokurori i rrethit realizon kete funksion) eshte Prokurori i Pergjithshem. Per pasoje edhe te drejten e shfuqizimit apo ndryshimit te vendimeve te pushimit te ceshtjes penale ne zbatim te nenit 24 te K.Pr.Penale e ka vetem Prokurori i Pergjithshem. Prokuroret e tjere, pra edhe ata prane Prokurorise se Pergjithshme, mund te marrin vendime per ndryshimin apo shfuqizimin e vendimit te pushimit te ceshtjes penale vetem me autorizim te posacem te Prokurorit te Pergjithshem. Ne se ato vendime merren apo jane marre pa nje autorizim te tille, nuk mund te sjellin asnje pasoje pasi jane marre ne kundershtim me ligjin. Menyra se si do te funksionoje dhenia e autorizimeve, eshte problem qe zgjidhet nga Prokurori i Pergjithshem.

Ne ceshtjen objekt gjykimi ne ngarkim te te pandehurit Pellumb Dyrmishi, Prokurori i Pergjithshem, duke shfuqizuar vendimin e pushimit te ceshtjes ne baze te nenit 24/4, ka zbatuar drejt ligjin e per pasoje arsyetimet e bera nga Gjykata e Apelit Durres qe e kane cuar ate ne marrjen e vendimit per

pushimin e ceshtjes jane te gabuara e te pabazuara ne ligj, prandaj vendimi i marre prej saj duhet te prishet e ceshtja te kthehet per rigjykim.

Duke patur parasysh se Gjykata e Apelit Durres nuk ka zhvilluar gjykim te plote te ceshtjes, por ka prishur vendimin e gjykates se rrethit dhe ka vendosur pushimin e ceshtjes ne baze te nenit 428/I/c te K.Pr.Penale duke pranuar se jane rastet qe nuk lejojne vazhdimin e procedimit, kjo ceshtje i duhet derguar per rishqyrtim Gjykates se Apelit Durres.

PER KETO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, ne baze te nenit 441/ç te K.Pr.Penale,

V E N D O S E N:

Prishjen e vendimit nr. 230 date 8.11.2000 te Gjykates se Apelit Durres dhe kthimin e akteve per rishqyrtim po asaj gjykate me tjeter trup gjykues.

Ky vendim per njesimin e praktikes gjyqesore te dergohet per botim ne Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICES

Mendimi i pakices eshte se vendimi nr.230, date 8.11.2000 i Gjykates se Apelit Durres, eshte rrjedhoje e zbatimit dhe respektimit te ligjes. Per rrjedhoje, ne perputhje me kerkesat e nenit 441, germa «a» te K.Pr.Penale, ai duhet te lihet ne fuqi.

Eshte vertetuar se i pandehuri Pellumb Dyrmishi para vitit 1995, ka shkuar si emigrant ne shtetin Grek, ku nderkohe ka emigruar edhe viktima Gentian Popa. Ky i fundit rezulton te jete gjetur i vdekur (djegur) ne zonen e Pireut, ne daten 8 shkurt 1995.

Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare Elbasan, mbasi ka zhvilluar hetimet paraprake rreth ceshtjes, ne daten 25.04.1997, ka vendosur pushimin e ceshtjes per mungese provash. Me pas, me Urdherin nr.17, date 01 mars 1999, Prokurori i Pergjithshem, ka shfuqizuar kete vendim dhe ne perfundim te hetimit, ceshtja ka kaluar per gjykim.

Gjykata e Shkalles se Pare Elbasan, mbasi ka zhvilluar gjykimin e ceshtjes, me vendimin e saj nr.95, date 13.09.2000, ka konkluduar duke deklaruar fajtor te pandehurin Pellumb Dyrmishi.

Ne te kundert, Gjykata e Apelit Durres, me vendimin nr.230, date 8 nentor 2000, konkludon per prishje te vendimit te gjykates se shkalles se pare dhe pushimin e ceshtjes. Arsyetimi i vendimit, ne vija te pergjithshme, mbeshtetet ne mospasjen e te drejtes se Prokurorit te Pergjithshem, per te shfuqizuar nje vendim pushimi te ceshtjes marre nga prokurori para gjykates se shkalles se pare. Me fjale te tjera, kerkesat e nenit 24/4 te K.Pr.Penale nuk e justifikojne nje te drejte te tille (behet fjale per periudhen para ndryshimit te kesaj dispozite).

Duke e pare ne teresine e tij vendimin e Gjykates se Apelit Durres, arrihet ne perfundimin se ai eshte i drejte, objektiv dhe ne perputhje te plote me kerkesat ligjore.

Se pari, prokuroria prane Gjykates se shkalles se pare Elbasan, mbasi ka zhvilluar hetimet, te cilat ajo i ka konsideruar si te nevojshme, ka vendosur ne daten 25 prill 1997, pushimin e ceshtjes penale. Ne kete vendim ajo nder te tjera ka arsyetuar, se nuk ka prova te mjaftueshme qe te vertetojne se i pandehuri ka kryer vepren penale per te cilen akuzohet.

Duke vepruar ne kundershtim me kerkesat ligjore, Prokurori i Pergjithshem, me urdherin date 1.3.1999, ka anulluar vendimin e siperpermendur te pushimit te ceshtjes. Nje vendim i tille nuk sjell dhe nuk mund te sjelle pasoja juridike, pra per rrjedhoje nuk mund te shfuqizoje vendimin e pushimit te marre nga prokurori prane gjykates se Shkalles se Pare Elbasan date 25.4.1997, sepse:

- Vendimi i pushimit te ceshtjes penale, eshte marre duke respektuar kerkesat procedurale te parashikuara nga neni 328 i Kodit te Procedures Penale.

- Vendimi ne fjale, ne perpupthje me kerkesat e parashikuara nga neni 329 i Kodit te Procedures Penale, mund te shfuqizohet vetem nga ana e gjykates se shkalles se pare, ne rast se ndaj tij eshte ushtruar

ankim nga ana e personave qe u eshte dhene kjo e drejte.

Prokurori i Pergjithshem, duke marre vendimin per shfuqizimin, nga ana tjeter nuk mund te «arsyetoje» se mbeshtetet edhe ne Ligjin nr.8460, date 11.2.1999 «Per disa shtesa ne Ligjin nr.7905, date 21.3.1995 «Per Kodin e Procedures Penale». Sipas ketij Ligji, ne nenin «24», pas pikes «4» shtohet pika «5», me kete permbajtje: Prokurori me i larte ka te drejte te vendose ndryshimin ose shfuqizimin e vendimeve te marra nga prokurori me i ulet.

Ligji ne fjale ka hyre ne fuqi me date 27 mars 1999, pra pas dy vjetesh nga marrja e vendimit te pushimit te ceshtjes dhe 26 ditesh nga nxjerrja e Urdherit per shfuqizimin e atij vendimi. Ne kete ligj, nuk behet fjale per «fuqi prapavepruese». Ne keto kushte ky ligj nuk mund te shtrije efektet e tij per veprime apo akte te realizuara para hyrjes se tij ne fuqi. Me fjale te tjera, konkludohet se ligji vepron per periudhen pas hyrjes se tij ne fuqi, me perjashtim te rasteve kur ai shprehet ndryshe.

Se dyti, vendimi i Gjykates se Apelit Durres eshte i drejte, duke e pare ceshtjen edhe ne nje kendveshtrim tjeter. Keshtu sipas kerkesave te nenit 24 pika 4 te Kodit te Procedures Penale, kemi: «Urdherat dhe udhezimet e prokurorit me te larte jane te detyrueshme per prokurorin me te ulet». Edhe ne kete rast, Prokurori i Pergjithshem nuk mund te marre nje vendim shfuqizim kunder vendimit te pushimit te ceshtjes penale, marre nga ana e prokurorit prane gjykates se shkalles se pare. Duke e pare me kujdes kete dispozite, pakica arrin ne perfundimin, se behet fjale per urdhera dhe udhezime, te cilat jepen ne nje faze te caktuar qe ka te beje vetem me hetimet paraprake. Pra brenda perbrenda nje hetimi te caktuar, i cili ende nuk ka perfunduar. Ne rastin konkret, kemi te bejme me nje Vendim pushimi te ceshtjes penale, i cili eshte perfunduar. Duke patur parasysh ceshtjen konkrete dhe analizen si me siper, kete vendim pushimi te ceshtjes penale, mund ta godase vetem vendimi i gjykates se shkalles se pare, pas realizimit te te drejtes se ankimit, sipas kerkesave te nenit 329 te K.Procedures Penale.

Nga ana tjeter, vete dispozita (neni 24/4 i K.P.P.) nuk ben fjale per Vendime te prokurorit me te larte, por vetem per Urdhera dhe Udhezime. Kjo nga njera ane. Nga ana tjeter, gje qe perben edhe nje argument me shume ne arritjen e perfundimit si me siper, eshte edhe fakti i miratimit te ligjit te cituar «Per disa shtesa ne ligjin nr.7905, date 21.3.1995». Ishte pikerisht boshlleku ligjor qe shihej ne kerkesat e nenit 24 te Kodit te Procedures Penale, qe beri rregullimin me ligj te te drejtes se prokurorit me te larte, per te ndryshuar ose shfuqizuar vendimet e prokurorit me te ulet, kur e shihte te arsyeshme. Me fjale te tjera, ky rregullim ligjor, verteton pikerisht faktin e mospasjes se kesaj te drejte me dispozitat e Kodit te Procedures Penale, para ndryshimit ne fjale.

Nga sa u tha dhe analizua pakica arrin ne perfundimin se vendimi i Gjykates se Apelit Durres, duhet te lihet ne fuqi si i mbeshtetur plotesisht ne ligj.

GJYQTAR:
Z. PODA

V E N D I M
Nr. 5, date 10.10.2002

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte te perbere nga:

Thimjo KondiKryesues
Perikli ZahariaAnetar
Kristaq Ngjela“
Spiro Spiro“
Bashkim Caka“
Valentina Kondili“
Nikoleta Kita“
Metush Saraci“
Vladimir Metani“
Vladimir Bineri“
Natasha Sheshi“
Zamir Poda“
Ylvi Myrtja“
Agron Lamaj“
Artan Hoxha“
Evgjeni Sinoimeri“
Irma Bala“

ne seancen gjyqesore te dates 10.10.2002, mori ne shqyrtim ceshtjen penale qe i perket :
KERKUES:Prokuroria e Pergjitheshme,
OBJEKTI: Njohja e vendimit penal te Gjykates se Apelit Selanik (Greqi) Nr.651, date 21.9.1999, ne ngarkim te shtetasit shqiptar Lutfi Daci.
Baza Ligjore:Neni 512, paragrafi i trete i K.Pr.Penale.

Gjykata e Rrethit Tirane, me vendimin nr. 10 (Akti), date 05.10.2000, ka vendosur:

Njohjen e vendimit penal te Gjykates se Apelit Selanik Nr.651, date 21.09.1999, qe i perket shtetasit shqiptar Lutfi Daci.

Denimi i dhene nga Gjykata Greke me 19 vjet e 6 muaj burgim, per vepren penale te mbajtjes e transportimit te lendeve narkotike kryer ne bashkepunim e ate te kalimit te paligjshem te kufirit konvertohet duke e denuar ne baze te nenit 283/1 e 25 te K.Penal me 15 vjet burgim e ne baze te nenit 297 te K.Penal me 1 vit burgim.

Ne zbatim te nenit 55 te K.Penal, duke bere bashkimin e denimeve e denon perfundimisht me 15 vjet burgim.

Gjykata e Rrethit Tirane, mbi kerkesen e te denuarit Lutfi Daci, me vendim nr.616 (Akti), date 29.10.2001, ka rivendosur ne afat te drejten e ankimit te tij kundra vendimit te Gjykates se Rrethit Tirane nr.10 (Akti), date 05.10.2000, per njohjen e vendimit penal te Gjykates se Apelit Selanik nr.651, date 21.9.1999.

Gjykata e Apelit Tirane, me vendimin nr.46, date 8.2.2002, ka vendosur:

Lenien ne fuqi te vendimit te Gjykates se Rrethit Tirane, nr.10 (Akti), date 5.10.2000 per njohjen e vendimit te Gjykates se Apelit Selanik nr.651, date 21.9.1999, qe i perket shtetasit shqiptar Lutfi Daci.

Ndryshimin e ketij vendimi per pjesen qe ka bere konvertimin e denimit per vepren penale te mbajtjes e transportimit te lendeve narkotike ne bashkepunim e ne baze te nenit 283/1 e 25 te K.Penal denimin e Lutfi Dacit me 10 vjet burgim e lenien ne fuqi te vendimit lidhur me denimin per vepren penale te kalimit te paligjshem te kufirit.

Ne zbatim te nenit 55 te K.Penal, duke bere bashkimin e denimeve, denimin e Lutfi Dacit perfundimisht me 10 vjet burgim.

Kunder vendimit te mesiperm te gjykates se apelit ka bere rekurs avokati B. Rusi, i cili kerkon ndryshimin e ketij vendimi dhe caktimin per te denuarin Lutfi Daci te nje denimi me te pershtatshem per arsyet e meposhtme:

-Kualifikimi ligjor i vepres se kryer nga i denuari Lutfi Daci duhet te ndryshohet nga neni 283 ne nenin 285 te Kodit Penal qe ka nje denim me te bute, per arsye se ai eshte kapur me kanabis-sativa me forme xhufke qe perdoren per prodhimin e lendeve narkotike pra, me lende qe ne gjendjen qe eshte kapur nuk eshte lende narkotike.

-Duke mbajtur parasysh kete kualifikim ligjor te vepres, faktin qe dispozitat e konventes per transferimin e personave te denuar lene hapsire per vendin ku behet njohja e denimit, te mund te beje uljen e tij. Rrethanat qe lidhen me vete te denuain Lutfi Daci lejojne qe te behet ulje e metejshme e denimit, duke i caktuar nje denim me te pershtatshem.

Ndersa prokuroria nuk i ka apeluar vendimet e siperpermendura te shkalles se pare dhe as ka ushtruar rekurs kunder vendimit te gjykates se Apelit.

KOLEGJET E BASHKUARA TE GJYKATES SE LARTE,

mbasi degjuan relatimin e gjyqtareve Bashkim Caka e Valentina Kondili, prokurorin Saliko Hajno qe kerkoi lenien ne fuqi te vendimit, mbrojtesin e te denuarit, avokat Baftjar Rusi, qe kerkoi ndryshimin e vendimit lidhur me masen e denimit, e pasi e diskutuan ceshtjen ne teresi,

V E R E J N E :

Nga materialet e dosjes gjyqesore rezulton se me vendimin gjyqesor te formes se prere nr.651,

date 21.09.1999 te Gjykates se Apelit Selanik, kerkuesi Lutfi Daci, shtetas shqiptar, eshte denuar me 19 vjet e gjashte muaj burgim per veprat penale te mbajtjes dhe transportimit te lendeve narkotike ne bashkepunim dhe kalim te paligjshem te kufirit shteteror.

I denuari Lutfi Daci ka kerkuar qe te transferohet ne Shqiperi per te vuajtur denimin e dhene nga gjykata e shtetit Grek, bazuar ne Konventen e Keshillit te Europes « Per transferimin e personave te denuar » dhe te marreveshjes bilaterale midis Greqise dhe Shqiperise date 17.5.1993 « Per ndihmen e ndersjellte gjyqesore ne fushen penale, civile dhe te transferimit te te burgosurve »

Gjykata e shkalles se pare Tirane, me vendimin nr.10 akti , date 29.10.2001 ka bere njohjen e vendimit penal te dhene nga gjykata e Selanikut te Greqise duke caktuar perfundimisht per te dy veprat penale 15 vjet burgim per te denuarin Lutfi Daci.

I denuari Lutfi Daci ka pretenduar se Gjykata e rrethit Tirane e ka marre vendimin e mesiperm ne mungese te tij, pa u perfaqesuar ai nga ndonje avokat mbrojtes i caktuar prej tij dhe as nga ndonje mbrojtes i caktuar kryesisht nga gjykata dhe, per rrjedhoje, ai ka marre dijeni per vendimin e dhene mbasi eshte bere transferimi i tij ne Shqiperi. Mbi bazen e ketij pretendimi i denuari ka kerkuar rivendosjen ne afat te ankimit.

Gjykata e shkalles se pare Tirane, me vendimin nr.616, akti, date 29.10.2001ka pranuar kerkesen e te denuarit dhe ka vendosur rivendosjen e tij ne afat per te bere ankim kunder vendimit nr.10 akti, date 29.10.2001 qe ka bere njohjen e vendimit penal te dhene nga gjykata e shtetit Grek. Gjykimi eshte zhvilluar pa pjesemarrjen e prokurorit dhe vendimi nuk i eshte komunikuar atij.

Gjykata e Apelit Tirane, me vendimin e saj nr.46, date 8.2.2002 ka vendosur ndryshimin e vendimit te gjykates se shkalles se pare lidhur me konvertimin e denimit dhe ka caktuar si mase denimi ndaj tij 10 vjet burgim duke arsyetuar se gjykata e rrethit ka vepruar drejt qe e ka kualifikuar krimin e kryer nga i denuari ne Greqi sipas nenit 283 te Kodit Penal te Shqiperise, por, sipas gjykates se Apelit, gjykata e rrethit ka gabuar qe e ka konvertuar denimin e dhene nga gjykata greke me maksimumin e denimit qe parashikon neni 283 i Kodit Penal shqiptar per krimin e mbrajtjes e transportimit te lendeve narkotike. Ne uljen e mases se denimit gjykata e Apelit ka vleresuar si rrethana lehtesuese faktin qe i denuari nuk ka qene perserites, qe ai eshte i martuar dhe ka ne ngarkim dy femije te mitur, si dhe faktin qe ka manifestuar sjellje te mira gjate vuajtjes se denimit ne burgun grek.

Per kete kategori ceshtjesh, ne praktiken e deritanishme te gjykatave te rretheve e te apeleve, kane dale disa probleme, qe kane te bejne me menyren e kuptimit dhe zbatimit te dispozitave te titullit te dhjete, kreut te trete, seksioni i pare i K.Pr.Penale, qe rregullojne ekzekutimin e vendimeve penale te huaja (nenet 512-518) dhe konkretisht:

1-Ne kuptim te neneve 407, 431, 432 dhe neneve 512 deri te 518 te K.Pr.Penale, a kane te drejte palet te bejne ankim kunder vendimit te shkalles se pare dhe rekurs kunder vendimit te gjykates se apelit, per rastet e vendimeve me te cilat eshte bere njohja e vendimeve penale te huaja dhe konvertimi i denimit?

2-A ka te drejte i pandehuri ose mbrojtesi i tij qe per kete kategori ceshtjesh qe kane te bejne me njohjen e vendimeve penale te huaja, ne zbatim te nenit 147 te K.Pr.Penale te kerkoje rivendosjen ne afat te ankimit per ne gjykaten e apelit ose te rekursit per ne Gjykaten e Larte?

3-Ne kuptim te neneve 512 deri 518 K.Pr.Penale, a ka te drejte gjykata e apelit te ndryshoje vendimin e gjykates se shkalles se pare qe ka bere njohjen e vendimit penal te huaj, duke ulur masen e denimit te konvertuar, e te dhene nga gjykata e rrethit, ne rastet kur ajo pranon shqyrtimin e ankimit?

Per keto arsye Kryetari i Gjykates se Larte, per te bere njesimin e praktikes gjyqesore, bazuar ne nenin 141 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, nenin 438 te K.Pr.Penale dhe nenin 14 te Ligjit Nr.8588, date 15.03.2000 « Per organizimin dhe funksionimin e Gjykates se Larte te Republikes se Shqiperise », ka vendosur terheqjen nga Kolegji Penal te ceshtjes penale nr.304, qe i perket te denuarit Lutfi Daci dhe kalimin e saj per shqyrtim ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte per unifikim te praktikes gjyqesore.

Kolegjet e Bashkuar te Gjykates se Larte verejne se numuri i ceshtjeve te kesaj natyre eshte rritur dhe mund te rritet me tej ne te ardhmen, dhe ne praktiken e gjykatave jane mbajtur qendrime te ndryshme, cka dikton nevojen e njesimit te praktikes gjyqesore ne drejtimet e mesiperme, per te siguruar nje kuptim e zbatim te drejte te dispozitave te mesiperme procedurale qe kane te bejne me njohjen e vendimeve

penale te huaja.

Ceshtja ne shqyrtim, si dhe ceshtje te tjera te ngjashme me te, e gjen zgjidhjen nepermjet interpretimit e zbatimit te disa akteve normative, sic jane: Konventa Europiane "Per transferimin e personave te denuar", ratifikuar me ligjin nr.8499, date 10.6.1999; Marrveshja bilaterale midis Republikes se Shqiperise dhe Republikes se Greqise "Per ndihmen e ndersjellte gjyqesore ne fushen penale, civile dhe ate te transferimit te te burgosurve", date 17.5.1993, ratifikuar nga parlamentet e te dy vendeve, si dhe dispozitat perkatese te K.Pr.Penale (nenet 512 – 518 etj te ketij Kodi).

Ne lidhje me kete kuader ligjor problemi i pare qe shtrohet per diskutim eshte ne se keto akte normative (dispozitat korespondonjese) jane ne harmoni me njera – tjetren (kompatibile) apo kemi kontradiksione e ndeshje (kolizione) midis tyre.

Ne eventualitetin e dyte eshte e domosdoshme te gjendet norma (normat) e zbatueshme ne funksion te zgjidhjes se ceshtjes.

Per kete, para se gjithash, duhet te nisemi nga rregullimi qe behet me norma te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise.

Duhet te kemi parasysh se, sipas nenit 122 te Kushtetutes, "1. Cdo marrveshje nderkombetare e ratifikuar perben pjese te sistemit te brendshem juridik pasi botohet ne Fletoren Zyrtare te Republikes se Shqiperise. Ajo zbatohet ne menyre te drejtperdrejte, pervec rasteve kur nuk eshte e vetezbatueshme dhe zbatimi i saj kerkon nxjerrjen e nje ligji …….

2. Nje marrveshje nderkombetare e ratifikuar me ligj ka epersi mbi ligjet e vendit qe nuk pajtohen me te.

……"

Nga permbajtja e dispozites Kushtetuese te sipercituar ka rendesi te nxirren ne pah keto perfundime:

1. Konventa Europiane (marrveshja kuader) dhe marrveshja bilaterale midis dy shteteve jane te inkluduara ne sistemin e brendshem juridik te Republikes se Shqiperise.

2. Keto dy akte normative kane zbatim te drejtperdrejte.

3. Ne rast mospajtimi, dispozitat e marrveshjeve nderkombetare te lartpermendura kane epersi mbi dispozitat e Kodit te Procedures Penale. Kjo do te thote se dispozitat e akteve juridike nderkombetare qendrojne me lart ne hierarkine e normave juridike te inkluduara ne te drejten e brendeshme te Republikes se Shqiperise, gje qe rezulton ne menyre implicite edhe prej nenit 116/1 te Kushtetutes.

Per sa parashtrohet me lart, nga studimi e vleresimi ne teresi i akteve juridike te lartpermendura, qe kane lidhje me ceshtjen ne shqyrtim, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte cmojne se midis tyre nuk ka ndonje papajtueshmeri. Ato konsiderohen komplementare me njera – tjetren, gje qe konfirmohet edhe nga fakti qe deri me sot ne marredheniet midis dy shteteve, lidhur me transferimin e te denuarve, eshte zbatuar nje praktike administrative e gjyqesore e pranuar ne menyre te ndersjellte dhe e pakontestuar. Per transferimin ne Shqiperi te shtetasve shqiptare te denuar ne Greqi, zbatimi i dispozitave ne fjale, qe jane pjese e rendit juridik te brendshem te Shqiperise, sipas interpretimit qe u bejne gjykatat shqiptare, varet nga pelqimi i personit te denuar qe ka kerkuar te transferohet ne Shqiperi, si dhe kryesisht nga miratimi perfundimtar i autoriteteve kompetente te shtetit te huaj.

Megjithate, ne marredheniet juridiksionale midis te dy paleve te marrveshjes bilaterale mund te lindin ne te ardhmen probleme ne qofte se do te vazhdohet sipas disa praktikave te deritanishme te disa gjykatave te rretheve e te Apeleve, te cilat kane nderhyre ne vendimet e konvertimit te denimeve pasi eshte perfunduar edhe procedura administrative e transferimit te te denuarve per te vazhduar vuajtjen e denimit te konvertuar ne burgjet shqiptare.

1. Prej ceshtjes ne shqyrtim rezulton se vendimi i gjykates se shkalles se pare per konvertimin e denimit eshte ankimuar ne Apel sipas rregullave te pergjitheshme te ankimit kunder vendimeve te themelit qe nuk kane marre forme te prere.

Para se t`i jepet pergjigje pyetjes se shtruar ne se vendimi i gjykates se shkalles se pare, me te cilin eshte bere njohja e vendimit penal te huaj dhe konvertimi i denimit, mund te ankimohet sipas rregullave te pergjitheshme, duhet te sqarojme tiparet dhe vecantite e procedures qe zbatohet ne keto raste dhe sidomos natyren e ketyre vendimeve qe merren nga gjykatat shqiptare, lidhur me nje ceshtje qe eshte gjykuar nga

nje gjykate e huaj sipas kuadrit ligjor penal te shtetit te vet, vendimi i se ciles ka marre forme te prere dhe eshte ekzekutuar rregullisht ne perputhje me ligjin e shtetit te huaj.

Sipas nenit 512/2 te K.Pr.Penale te Republikes se Shqiperise, " …Ministria e Drejtesise kerkon njohjen e nje vendimi penal te huaj edhe kur cmon se ne baze te nje marrveshjeje nderkombetare ky vendim duhet te ekzekutohet ose t`i njihen efekte te tjera ne shtetin shqiptar."

Nisur nga permbajtja e dispozites se mesiperme rezulton se Ministria e Drejtesise eshte autoriteti i vetem i ngarkuar ligjerisht te mbaje marredheniet juridiksionale me autoritetet e huaja per njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve penale te huaja. Megjithate Ministria e Drejtesise nuk ka akces te drejtperdrejte ne gjykatat shqiptare. Ne rastin e njohjes se nje vendimi penal te huaj dhe ekzekutimit te tij ne shtetin shqiptar (konvertimin) Ministria e Drejtesise i a paraqet gjithe dokumentacionin e nevojshem me kerkesen perkatese prokurorise, e cila eshte autoriteti i vetem kompetent qe legjitimohet per te vene ne levizje gjykaten (neni 512/3 te K.Pr.Penale).

Sipas Konventes Europiane per transferimin e personave te denuar, organet kompetente te shtetit zbatues a) vazhdojne ekzekutimin e vendimit te dhene ne shtetin denues menjehere, ose b) konvertojne denimin e dhene ne shtetin denues duke caktuar sanksione sipas legjislacionit te shtetit zbatues.

Shteti shqiptar, ne rastin e ratifikimit te Konventes, nuk ka pranuar vazhdimin e ekzekutimit te menjehershem te denimit, sipas te cilit shteti zbatues eshte i detyruar t'i permbahet natyres ligjore dhe kohezgjatjes se denimit, sic eshte percaktuar ne shtetin denues, por ka pranuar konvertimin e denimit ne pershtatje me kerkesat e dispozites homologe te Kodit Penal shqiptar.

Dispozitat e neneve 512 deri ne 518 te Kodit te Procedures Penale ne rastin e njohjes se vendimeve penale te huaja trajtojne konvertimin, i cili eshte ne harmoni me trajtimin qe i ben konvertimit te denimit edhe Konventa Europiane. Kriteret e gjykimit dhe natyra e vendimit qe merret per konvertimin rezultojne nga permbajtja e nenit 516 te K.Pr.Penale.

Kur ben njohjen e nje vendimi penal te huaj, sipas ligjit tone penal, gjykata cakton denimin qe duhet te vuhet ne shtetin shqiptar. Gjykata konverton denimin e caktuar ne vendimin e huaj ne nje nga denimet e parashikuara per te njejtin fakt nga ligji shqiptar, i cili duhet t'i pergjigjet nga natyra atij qe eshte dhene ne vendimin e huaj. Masa e denimit nuk mund te kaloje kufirin maksimal te parashikuar per te njejtin fakt nga ligji shqiptar. Ligji parashikon edhe rastin kur ne vendimin e huaj nuk eshte caktuar masa e denimit dhe mban qendrimin se eshte gjykata shqiptare ajo qe cakton ate mbi bazen e kritereve te treguara ne Kodin Penal. Pervec ketyre, ne nenin 516 te Kodit te Procedures Penale trajtohen edhe rregullat e caktimit te denimit lidhur me vendime penale te shteteve te huaja qe kane te bejne me caktimin e denimeve me gjobe, konfiskimeve, kur i pandehuri eshte liruar me kusht ose kur ekzekutimi i vendimit te dhene ne shtetin e huaj eshte pezulluar me kusht.

Ne rastin e konvertimit te denimit sipas Konventes, gjykata e shtetit zbatues nuk mund te konvertoje nje denim me burgim ne nje denim me gjobe, gjykata mund te shkurtoje periudhen e plote te heqjes se lirise qe vuhet nga personi i denuar. Gjykata nuk e rendon denimin e personit te denuar dhe nuk eshte e detyruar t'i permbahet ndonje minimumi qe mund te parashikoje ligji i vendit zbatues per vepren ose veprat e kryera.

Nga interpretimi i dispozitave te Konventes dhe ligjit tone procedural del e qarte se ne rastin e konvertimit te denimit, zbatohen procedurat e parashikuara nga ligji i shtetit zbatues. Kur behet konvertimi i denimit gjykata duhet t'u permbahet konstatimeve per faktet kur ato shfaqen shprehimisht ose nenkuptohen nga vendimi i dhene nga shteti zbatues. Kolegjet e Bashkuara, edhe ne nje vendim te meparshem unifikues nr.154 date 15.4.2000 kane konkluduar se vendimi i gjykates shqiptare qe ben konvertimin nuk eshte nje vendim i ri dhe se gjykata shqiptare nuk e shqyrton ceshtjen ne themel dhe as nuk verifikon provat e marra nga gjykata e shtetit denues. Gjykata shqiptare verifikon nese ekzistojne kushtet per njohjen e vendimit te huaj dhe i pergjigjet atij vendimi me nje vendim qe konverton denimin e huaj me nje denim te parashikuar nga legjislacioni shqiptar, duke percaktuar edhe dispozitat perkatese qe aplikohen.

Eshte e tepert qe ne kete vendim te citohet tere permbajtja e vendimit unifikues nr.154 date 15.4.2000 te Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte. Edhe praktika e Kolegjit Penal te kesaj gjykate ne lidhje me problemin qe shqyrtojme ka qene dhe eshte konstante dhe konsekuente. P.sh. ne vendimin

nr.57, date 23.1.2002, ne ceshtjen qe i perket te denuarit Hysni Tafili, Kolegji Penal i Gjykates se Larte ka vendosur te prishe vendimin nr.85, date 27.07.2001 te gjykates se Apelit Vlore, nder te tjera, me arsyetimin se « ... ne procesin e njohjes ese vendimit te huaj) dhe te caktimit te denimit e (qe duhet te vuhet ne shtetin shqiptar) gjykatat bejne kujdes qe denimi i cili do te vuhet ne territorin shqiptar t`i pergjigjet per nga natyra vendimit te huaj dhe jo ta rivleresoje kete te fundit ne komponentet e tij ».

Duke mos respektuar interpretimin unifikues te bere nga Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte ne zgjidhjen e nje ceshtjeje te ngjashme, gjykata e apelit i ka lejuar vehtes nje shkelje te rende te ligjit. Sipas nenit 438/4 te K.Pr.Penale , « Vendimi i Kolegjeve te Bashkuara eshte i detyrueshem per gjykatat ne gjykimin e ceshtjeve te ngjashme ».

* * *

Le t`i kthehemi trajtimit te problemit te ankimit ndaj vendimit te konvertimit te denimit te huaj ne pershtatje me Kodin Penal shqiptar. As neni 516 i K.Pr.Penale e as ndonje dispozite vijuese nuk shprehet per te drejten e ankimit. Ne nenin 518 te K.Pr.Penale, permenden ne menyre te shprehur vetem dy momente: 1. Njohja e vendimit te huaj dhe 2. Ekzekutimi i vendimit nga prokurori sipas ligjit shqiptar.

Megjithate, pavaresisht nga sa me lart si dhe nga formulimi i nenit 407 te Kodit te Pr.Penale (« 1. Ligji cakton rastet ne te cilat vendimet dhe urdherat e gjykates mund te ankimohen, si dhe mjetin e ankimit.....

4. E drejta e ankimit i takon vetem atij qe ligji i a njeh shprehimisht .....), Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte jane te mendimit qe si prokurorit, ashtu edhe mbrojtesit te te denuarit, per te cilin behet konvertimi i denimit te huaj, nuk mund t`u mohohet e drejta e ankimit kunder vendimit te gjykates per kete ceshtje, megjithese ky lloj gjykimi nuk eshte gjykim themeli, por nje gjykim i posacem (sui generis).

Vendimi i konvertimit te denimit te huaj ne pershtatje me legjislacionin shqiptar, qe jepet nga gjykata shqiptare, pavaresisht nga natyra e tij, eshte ne fund te fundit nje vendim gjyqesor dhe, sipas nenit 43 te Kushtetutes, « Kushdo ka te drejte te ankohet kunder nje vendimi gjyqesor ne nje gjykate me te larte, pervecse kur ne Kushtetute parashikohet ndryshe ».

Gjykimi i konvertimit, nga natyra e tij dhe rrethanat objektive ne te cilat zhvillohet, nuk mund te kete pranine e te denuarit qe u ka kerkuar autoriteteve te huaja kompetente te transferohet ne Shqiperi. I denuari qe eshte duke vuajtur denimin me burgim ne nje shtet te huaj objektivisht nuk mund te paraqitet ne gjykaten shqiptare, por ai ka te drejte dhe ka mundesi qe, ne momentin kur u drejtohet autoriteteve te huaja per te nisur proceduren e transferimit, te autorizoje nje mbrojtes te tij qe ta perfaqesoje ne gjykaten shqiptare. Ne qofte se ne fillim te gjykimit te konvertimit, gjykata shqiptare konstaton se mbrojtesi i caktuar nga i denuari nuk eshte paraqitur pa shkaqe te arsyeshme, ose ai nuk ka autorizuar ndonje mbrojtes, atehere gjykata eshte e detyruar t`i caktoje nje te tille kryesisht. Vendimi i konvertimit mund te ankimohet nga palet ne Apel. Vetem pasi vendimi i konvertimit merr forme te prere prokurori ka te drejte te kryeje veprimet e ekzekutimit, nepermjet dergimit te akteve Ministrise se Drejtesise per te vazhduar kryerjen e veprimeve administrative me autoritetet e huaja nepermjet te cilave do te realizohet transferimi i te denuarit.

2. Ceshtja tjeter e shtruar para Kolegjeve te Bashkuara per unifikim te praktikes gjyqesore eshte nese ka te drejte i pandehuri ose mbrojtesi i tij qe per kete kategori ceshtjesh qe kane te bejne me njohjen e vendimeve penale te huaja, ne zbatim te nenit 147 te K.Pr.Penale, te kerkoje rivendosjen ne afat te ankimit.

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte verejne se referimi per kete problem ne nenin 147/2 te K.Procedures Penale eshte i gabuar. Kjo dispozite zbatohet vetem per rivendosje ne afat per te bere ankim te te pandehurit te gjykuar ne mungese per shkak se gjykata ka konkluduar qe ai ishte larguar e i fshihej gjykimit, kur ky i fundit provon se nuk ka marre dijeni per vendimin. Pra, sipas kesaj dispozite kemi te bejme me rivendosje ne afat per te bere ankim kunder nje vendimi themeli, gje qe ndryshon teresisht, prej rastit ne shqyrtim. Eshte e vertete se i denuari Lutfi Daci ne gjykimin e konvertimit te denimit nuk eshte perfaqesuar nga ndonje mbrojtes dhe gjykata ishte e detyruar t`i caktonte nje te tille kryesisht. Megjithate pretendimi i tij per t`u rivendosur ne afatin e ankimit kunder ketij vendimi, per shkak se nuk ka marre

dijeni per te, nuk qendron. Vendimi i konvertimit te denimit i dhene nga gjykata shqiptare u eshte transmetuar autoriteteve greke dhe i denuari, qe kish kerkuar transferimin, kishte te drejte te njihej me vendimin e konvertimit para fillimit te procedurave te transferimit.

Ne qofte se nuk do te ishte dakord me kete vendim te konvertuar, atehere ai nuk mund te sillej ne Shqiperi ne kundershtim me deshiren e tij. Autoritetet e shtetit te huaj ishin te detyruara te prisnin deri sa i denuari te apelonte vendimin e gjykates shqiptare dhe deri sa vendimi i Apelit te merrte forme te prere.

Theksojme gjithashtu se vertetimi date 26.10.2001 i leshuar nga Drejtori i Burgut Vaqar, sipas te cilit i denuari Lutfi Daci ka marre dijeni per denimin e konvertuar pasi eshte transferuar ne Shqiperi me date 26.9.2001, nuk eshte i vlefshem per kete qellim, sepse eshte dhene jashte kompetencave te parashikuara ne ligj dhe nuk pasqyron te verteten. Komunikimet e vendimeve behen nga autoritetet e ngarkuara me ligj dhe ekzekutimi i tyre nga prokurori, i cili pergjigjet edhe per ligjshmerine e ekzekutimit.

Si perfundim, i denuari, ose mbrojtesi i tij, nuk kane te drejte te kerkojne rivendosjen ne afat te se drejtes per te ushtruar ankim kunder vendimit te konvertimit te vendimit te nje gjykate te huaj.

Duke qene se prokurori eshte i ngarkuar ligjerisht me ekzekutimin e vendimit, eshte detyre e tij qe te sigurohet ne se vendimi ka marre forme te prere, pastaj te veje ne levizje Ministrine e Drejtesise per transferimin e te burgosurit. Ishte detyre e prokurorit qe te ankimonte vendimin e rivendosjes ne afat nga gjykata e shkalles se pare, si dhe te ushtronte rekurs kunder vendimit te gjykates se Apelit, detyre te cilen nuk e ka kryer.

Prokurori eshte i detyruar ligjerisht te garantoje paraprakisht qe, kur i denuari te kete realizuar te drejten e transferimit nga vendi i huaj ne Shqiperi per te vazhduar te vuaje denimin e dhene nga gjykata e huaj dhe te konvertuar sipas legjislacionit shqiptar, te jene kryer te gjitha veprimet procedurale dhe administrative midis autoriteteve shqiptare dhe atyre te huaja ne perputhje te plote me kuadrin ligjor ne fuqi, si dhe te jene respektuar rigorozisht te drejtat e te denuarit te transferuar, dhe, per rrjedhoje, ketij te fundit ne kohen e kthimit ne Shqiperi t`i jene mbyllur ligjerisht te gjitha rruget e zakonshme te ankimit.

3. Ne lidhje me ceshtjen e trete te shtruar per diskutim per efekt te unifikimit te praktikes gjyqesore, Kolegjet e Bashkuara jane te mendimit se gjykata e Apelit nuk duhet te dale jashte kufinjve te shqyrtimit te ceshtjes ne gjykaten e shkalles se pare dhe jashte shkaqeve te ankimit qe jane te pranueshme per t`u konsideruar, sipas natyres specifike te gjykimit te konvertimit te denimit ne pershtatje me kerkesat e kriteret e dispozitave analoge te Kodit Penal Shqiptar.

Gjykata e Apelit duhet te korigjoje gabimet ligjore eventuale te gjykates se shkalles se pare lidhur me zbatimin e kritereve dhe rregullave te konvertimit te denimit. Ajo nuk mund t`i hyje shqyrtimit te problemeve te bazueshmerise faktike e ligjore te vendimit te huaj, as kritereve te konsideruara nga gjykata e huaj per caktimin e denimit, si dhe cdo aspekti tjeter qe ka te beje me themelin e ceshtjes, vendimi i se ciles ka marre forme te prere dhe eshte ne proces ekzekutimi.

Gjykata e Apelit Tirane ka gabuar rende duke dale tej kufijve qe permenden me siper per kete lloj gjykimi. Ajo ne fakt ka dhene nje denim te ri me te zbutur duke prekur themelin e vendimit te gjykates se huaj, gje qe nuk ka te drejte ta beje.

Gjykata e Apelit nuk ka te drejte te marre prova, sic ka vepruar per kryerjen e ekspertimit per llojin e droges, as te beje vleresime te provave te marra nga gjykata e shtetit te huaj. Ajo nuk ka te drejte gjithashtu te marre ne konsiderate e te vleresoje si lehtesuese rrethana te caktuara, pavaresisht ne se jane marre ato ne shqyrtim e jane vleresuar, apo jo, nga gjykata e huaj.

I gabuar eshte edhe qendrimi i gjykates se Apelit qe justifikon uljen e mases se denimit me burgim me arsyetimin se denimi i dhene nga gjykata greke eshte konvertuar me maksimumin qe parashikon dispozita homologe e K.Penal shqiptar (neni 283). Neni 516/1 i K.Pr.Penale te Republikes se Shqiperise parashikon qarte e pa ekuivoke se, « ... Masa e denimit nuk mund te kaloje kufirin maksimal te parashikuar per te njejtin fakt nga ligji shqiptar ». Ne kuptim te po kesaj dispozite denimi i konvertuar nga gjykata shqiptare e shkalles se pare nuk mund te konsiderohet se nuk i pergjigjet nga natyra atij te dhene ne vendimin e huaj.

Tranferimi i te denuarit per te vuajtur ne shtetin e tij denimin e dhene nga nje gjykate e huaj nuk perben nje lehtesi ne kuptim te uljes se mases se denimit, por nje lehtesi per efekte te reabilitimit me te shpejte te tij ne pershtatje me kushtet me te favorshme qe mund te ofroje ne kete drejtim rendi juridik

shqiptar, por gjithesesi pa lejuar ne asnje rast rendimin e pozites se tij ne krahasim me qendrimin e mbajtur ne vendimin e gjykates se huaj.

Si perfundim, mbeshtetur ne interpretimin e mesiperm te nenit 516/1 te K.Pr.Penale, rezulton se gjykata e Apelit pa asnje shkak te perligjur ka ulur masen e denimit te caktuar pas konvertimit nga gjykata e shkalles se pare.

Nga sa me lart rezulton se vendimi i gjykates se shkalles se pare qe ka rivendosur ne afat ankimin e te denuarit, si dhe vendimi i gjykates se apelit Tirane, qe i ka zbritur te denuarit 5 vjet nga denimi i burgimit, jane haptazi te kundraligjshem. Megjithate keto vendime nuk mund te cenohen sepse nuk kemi reagim procedural te prokurorit. Me kete rast u behet verejtje te dy gjykatave me qellim qe shkelje te tilla te mos perseriten me ne te ardhmen.

Arsyetimi si me siper i vendimit dhe argumentat e perdorura ne te rrezojne njekohesisht te gjitha pretendimet e avokatit te te denuarit te parashtruara ne rekurs.

PER KETO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte ne baze te nenit 141 te Kushtetutes dhe te nenit 438 te K.Pr.Penale.

V E N D O S E N:

1. Lenien ne fuqi te vendimit nr.46, date 8.2.2002 te gjykates se Apelit Tirane.
2. Ky vendim per njesimin e praktikes gjyqesore dergohet per botim ne Fletoren Zyrtare.

V E N D I M
Nr. 6, datë 11.10.2002

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte te perbere nga:

Thimjo KondiKryesues
Perikli ZahariaAnetar
Kristaq Ngjela “
Ylvi Myrtja “
Agron Lamaj “
Natasha Sheshi “
Spiro Spiro “
Nikoleta Kita “
Bashkim Caka “
Artan Hoxha “
Valentina Kondili “
Vladimir Metani “
Vladimir Bineri “
Zamir Poda “
Evgjeni Sinoimeri “
Irma Bala “
Metush Saraci “

ne seancen gjyqesore te dates 11.10.2002, moren ne shqyrtim ceshtjen penale nr. 7, qe i perket:

KERKUES: EDMIR GJOKICAJ, i biri i Xhevdetit, i datelindjes 1973, banues ne Shkoder, i denuar.
OBJEKTI: Rishikimi i vendimit penal te formes se prere Nr. 85, date 17.3.2000, te Gjykates se rrethit Gjyqesor Shkoder.

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Shkoder, me vendimin nr. 256, date 22.10.2001, ka vendosur mospranimin e kerkeses per rishikimin e vendimit penal nr. 85, date 17.3.2000 te po asaj gjykate, dhene ndaj te denuarit Edmir Gjokicaj.

Gjykata e Apelit Shkoder, me vendimin Nr. 197, date 21.12.2001 vendosi ndryshimin e vendimit

te mesiperm, pranimin e kerkeses per rishikim dhe kthimin e akteve Gjykates se shkalles se pare te rrethit gjyqesor Shkoder, per shqyrtimin e ceshtjes.

Kunder vendimit te Gjykates se Apelit Shkoder ka ushtruar rekurs prokurori, i cili kerkon prishjen e tij dhe kthimin e ceshtjes po asaj gjykate per rishqyrtim duke parashtruar keto shkaqe:

- Ne kerkesen per rishikim jane paraqitur si prova te reja tre deklarata noteriale mbi bazen e te cilave kerkohet shqyrtimi i ceshtjes e dhenia e pafajesise. Keto tre deklarata gjykata i quan ligjore e te marra konform rregullave proceduriale duke mos patur parasysh kerkesat e neneve 450 e 452 te K.Pr.Penale.

- Deklarat noteriale te paraqitura nuk mund te konsiderohen prova te reja e ato nuk mund te sjellin bindje per tu trajtuar ne gjykimin e ceshtjes.

Kolegji Penal i Gjykates se Larte, me vendimin nr. 353, date 23.5.2002, vendosi kalimin e ceshtjes ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte per unifikim te praktikes gjyqesore ne lidhje me ceshtjet e meposhtme:

1. Ne kuptim te nenit 453/2 te K.Pr.Penale, a ka te drejte prokurori te beje ankim kunder vendimit te pranimit te kerkeses per rishikim dhe ne pergjithesi, pala jo kerkuese, kunder vendimit te pranimit te kerkeses?

2. Çfare do te kuptohet me rregullimin ligjor te parashikuar nga neni 450, pika 1, shkronja “c”, kur thuhet se: “Kur pas vendimit kane dale, ose jane zbuluar prova te reja..”? Per kete duhen patur parasysh edhe ato prova qe nuk jane shqyrtuar gjate gjykimit dhe qe nuk jane kerkuar nga palet, megjithese diheshin prej tyre, apo vetem ato qe jane zbuluar pas dhenies se vendimit, me kusht qe pala qe e kerkon te mos kish dijeni per ekzistencen e tyre?

KOLEGJET E BASHKUARA TE GJYKATES SE LARTE,

pasi degjuan relacionet e anetareve Nikoleta Kita dhe Bashkim Caka, prokurorin Artur Selmani, i cili kerkoi lenien ne fuqi te vendimit te Gjykates se Apelit Shkoder, perfaqesuesin e kerkuesit avokat Fatos Shanaj, i cili kerkoi lenien ne fuqi te vendimit te Gjykates se Apelit Shkoder dhe pasi e biseduan ceshtjen ne teresi,

V E R E J N E:

Vendimi nr. 197, date 21.12.2001, i Gjykates se Apelit Shkoder eshte i pabazuar ne ligj dhe si i tille duhet te prishet.

Gjate shqyrtimit te akteve qe ndodhen ne dosjen penale qe i perket kerkuesit Edmir Gjokicaj dhe gjate gjykimit te ceshtjes ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, u konstatua se, me vendimin nr. 85, date 17.3.2000, kerkuesi eshte deklaruar fajtor per krimet e vrasjes me dashje dhe te mbajtjes pa leje te armeve luftarake, parashikuar nga nenet 76 dhe 278/II te Kodit Penal per te cilat u denua me 15 (pesembedhjete) vjet burgim, vendim, i cili u la ne fuqi nga Gjykata e Apelit Shkoder, me vendimin e saj nr. 54, date 28.04.2000 dhe nga Kolegji Penal i Gjykates se Larte, me vendimin nr. 482, date 10.11.2000, te tij.

Me date 2.10.2001, avokatet Kujtim Capo e Bahri Piri paraqiten, ne Gjykaten e rrethit gjyqesor Shkoder, kerkese per rishikimin e vendimit te saj nr. 85, date 17.3.2000, me pretendimin se, pas dhenies se ketij vendimi, jane zbuluar prova te reja, te paditura me pare, qe hedhin drite mbi pafajesine e kerkuesit.

Bashke me kerkesen, si prova te reja, te zbuluara rishtazi, ne kuptim te nenit 450/c te K.Pr.Penale, u paraqiten tre deklarata ne emer te shtetasve Ruzhdi Tafili, Skender Mani dhe Nazmi Mehja, (pa shenuar daten e leshimit te tyre), nenshkrimet e te cileve jane vertetuar nga noteri Klement Radovani, me 12.10.2001.

Me ane te ketyre deklaratave, ata shprehen se, diten dhe oren e vrasjes (per te cilen eshte deklaruar fajtor dhe denuar kerkuesi), e kane pare ate, duke festuar ditelindjen, duke ngrene e duke pire, ne fshatin Zus, vend ky i ndryshem nga vendi ku kishte ndodhur ngjarja.

Gjykata e rrethit gjyqesor Shkoder, me vendimin nr. 256, marre ne dhomen e keshillimit me date

22.10.2001, vendosi mospranimin e kerkeses me arsyetimin se ajo eshte bere jashte rasteve te parashikuara nga neni 450 i K.Pr.Penale dhe se kuptimi i shkronjes “c” te kesaj dispozite eshte qe prova e pretenduar te kete ekzistuar ne kohen e kryerjes se vepres penale, por objektivisht, ajo nuk njihej ose nuk mund te merrej.

Ky vendim u ndryshua nga Gjykata e Apelit Shkoder, duke vendosur pranimin e kerkeses per rishikim me arsyetimin se ajo eshte bere ne perputhje me kerkesat e nenit 450/c te K.Pr.Penale.

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte arriten ne perfundimin se vendimi i Gjykates se Apelit Shkoder eshte marre jo ne perputhje me kerkesat e K.Pr.Penale.

Pervec kesaj, ne marrjen e vendimit nga ana e asaj gjykate (Gjykates se Apelit Shkoder) nuk jane patur parasysh edhe disa parregullsi ne dokumentacionin e paraqitur nga kerkuesi bashke me kerkesen per rishikim, parregullsi qe jane lejuar nga gjykata e shkalles se pare, qe ne fillim kur eshte depozituar ky dokumentacion ne sekretarine e asaj gjykate dhe te cilat jane anashkaluar, pa u vene ne dukje, edhe nga Gjykata e Apelit Shkoder.

Keshtu, nga shqyrtimi i akteve qe ndodhen ne dosje, konstatohet se, ne vete kerkesen qe eshte paraqitur, nga avokatet, per rishikim, nuk eshte shenuar data ne te cilen ajo eshte perpiluar. Nderkohe, konstatohet se, ne permbajtjen e kesaj kerkese, pervec te tjerave, thuhet se i paraqiten gjykates, bashkengjitur, deklaratat e shtetasve Ruzhdi Tafili, Skender Mani e Nazmi Nuh Mehja.

Mirepo, megjithese, ne te tre keto deklarata nuk eshte shenuar data e leshimit, ne shpinen e seciles prej tyre, figuron autentifikimi i nenshkrimit te deklaruesve nga noteri Klement Radovani, autentifikim qe mban daten 12.10.2001, dmth 16 dite pas dates qe mban shenimi per ardhjen e kerkeses per rishikim ne gjykaten e shkalles se pare.

Keto parregullsi ngjallin dyshime se sekretaria gjyqesore ka lejuar qe edhe pas depozitimit te akteve e formimit te dosjes te behen nderhyrje ne to, duke kompromentuar rende rregullsine e procesit gjyqesor, mbasi nuk ka asnje garanci per nje proces te paanshem, objektiv e te ndershem.

Parregullsi te kesaj natyre diktonin kthimin, ne rruge administrative, pa veprim, te ketyre akteve, nga ana e sekretarise se gjykates dhe meqenese ato u lejuan derisa kerkesa u shqyrtua ne dhomen e keshillimit dhe ceshtja arriti per t’u gjykuar ne gjykaten e apelit, kjo e fundit duhej te vendoste mosmiratimin e ankimit, duke i vene ne dukje, ne vendimin e saj, keto parregullsi, si te meta serioze per gjykaten e shkalles se pare.

Persa u takon problemeve ligjore, qe kane lindur gjate gjykimit te ceshtjeve me objekt rishikimin e vendimeve penale te formes se prere, per unifikimin e te cilave kjo ceshtje ka ardhur ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, keto kolegje arriten ne perfundimet e meposhtme:

Persa i perket ceshtjes se pare qe eshte shtruar per unifikimin e praktikes gjyqesore te deritanishme, sipas se ciles a ka te drejte prokurori, dhe ne pergjithesi pala jo kerkuese, te beje ankim kunder vendimit te pranimit te kerkeses per rishikim, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte çmojne se kesaj çeshtjeje i duhet dhene pergjigje e kushtezuar me ndryshimet qe jane bere ne K.Pr.Penale, ne lidhje me institutin e rishikimit te vendimeve penale te formes se prere, me ligjin nr. 8813, date 13.6.2002, “Per disa shtesa e ndryshime ne ligjin nr. 7595, date 21.3.1995 “Kodi i Procedures Penale i Republikes se Shqiperise”, ndryshime keto te bera nga ligjvenesi pasi per kerkesen per rishikim, objekt shqyrtimi ne keto kolegje, ishin marre vendimet perkatese si nga gjykata e shkalles se pare, ashtu edhe nga ajo e apelit. Kjo ka te beje sidomos me faktin se, ndryshe nga ç’parashikohej ne nenin 452 te K.Pr.Penale, (te pandryshuar) qe kerkesa e rishikimit paraqitej ne sekretarine e gjykates se rrethit qe kishte dhene vendimin, e cila e shqyrtonte ate ne dhomen e keshillimit, me ndryshimet qe ka pesuar kjo dispozite, kerkesa bashke me provat dhe dokumentet eventuale qe e perligjin ate, paraqitet ne sekretarine e Gjykates se Larte (neni 57 i ligjit nr. 8813, date 13.6.2002), Kolegji Penal i se ciles e shqyrton ate ne dhomen e keshillimit, pa pranine e paleve. Vendimi i ketij kolegji eshte i formes se prere, si kur vendoset mospranimi, ashtu edhe pranimi i kerkeses (neni 58 i ligjit nr. 8813, date 13.6.2002). Keshtuqe, problemi nese ka apo jo te drejte prokurori dhe ne pergjithesi pala jo kerkuese te beje ankim kunder vendimit te pranimit te kerkeses per rishikim, vetvetiu duhet te konsiderohet i kapercyer tashme.

Ne rastet kur Kolegji Penal i Gjykates se Larte pranon kerkesen per rishikim, vendos prishjen e vendimit te formes se prere dhe ceshtjen e dergon per rigjykim, nga nje tjeter trup gjykues, ne gjykaten e

shkalles se pare qe ka dhene vendimin ose ne gjykaten e apelit, kur kerkesa eshte bere vetem kunder vendimit te kesaj te fundit.

Kuptohet qe, ne keto raste edhe prokurori dhe ne pergjithesi pala jo kerkuese, legjitimohet te ushtroje te gjitha te drejtat e pjesemarresve ne procesin penal, perfshire edhe te drejten e ankimit, ne gjykaten me te larte, kunder vendimit te gjykates se shkalles se pare dhe te apelit kur nuk eshte i te njejtit mendim me menyren e zgjidhjes se ceshtjes se rishikuar, tashme, prej tyre.

Ne kete perfundim arrihet duke u nisur nga permbajtja e dispozites se nenit 455/1 te K.Pr.Penale, sipas se ciles ne gjykimin e rishikimit respektohen dispozitat e gjykimit te shkalles se pare brenda kufijve te shkaqeve te parashtruara ne kerkesen e rishikimit.

Ne lidhje me ceshtjen tjeter qe eshte shtruar per unifikim para Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte, e cila ka te beje me kuptimin e shkronjes "c" te nenit 450 te K.Pr.Penale, per te arritur ne perfundime sa me te sakta e te drejta ne harmoni me frymen e pergjithshme te legjislacionit procedurial penal ne fuqi ne Republiken e Shqiperise dhe me qellimin e ligjvenesit ne parashikimin e institutit te rishikimit te vendimeve penale te formes se prere, gjate shqyrtimit te kesaj ceshtjeje, Kolegjet e Bashkuara, çmojne se duhet patur parasysh jo thjesht dhe vetem kuptimi i permbajtjes se kesaj shkronje, por interpretimi teresor i kesaj dispozite ne frymen e kuptimit dhe qellimit te institutit te rishikimit, ne pergjithesi dhe te problemeve qe zgjidhen ne praktike nepermjet zbatimit drejt te dispozitave te ketij instituti rast pas rasti, ne veçanti, ne kuader te dhenies se drejtesise ne kuptimin e plote te kesaj fjale, dmth per dhenien dhe zbatimin perfundimtar te vendimeve penale qe i pergjigjen realisht te vertetes.

Dihet se, rishikimi i vendimeve penale te formes se prere eshte nje mjet i jashtezakonshem, madje i vetmi, qe parashikohet nga ligjvenesi ne K.Pr.Penale per te ndrequr gabimet e mundshme gjyqesore, (ne lidhje me vendimet e formes se prere).

Procesi gjyqesor qe zhvillohet nepermjet rishikimit, nuk eshte nje proces thjeshte revizionimi, (ne kuptimin e ngushte te fjales), te nje procesi te meparshem, por gjykata ne perfundim te tij, mbasi administron e vlereson faktet, rrethanat dhe provat qe jane paraqitur rishtaz nga palet, se bashku dhe ne harmoni me provat, rrethanat dhe faktet e administruara dhe te vleresuara ne perfundim te gjykimit te meparshem, mund te arrije ne perfundime te ndryshme, madje dhe krejtesisht te kunderta me ato qe kishte arritur ne gjykimin e pare dhe te jape vendim po krejtesisht te kundert. Nga vendim fajesie qe mund te jete dhene ne perfundim te gjykimit te pare, gjykata, ne perfundim te gjykimit te rishikimit mund te dale me vendim pafajesie (kur kerkesa e rishikimit behet nga pala e te denuarit) dhe anasjelltas (kur kerkesa e rishikimit behet nga prokurori).

Eshte pikerisht kjo arsyeja qe ligjvenesi rishikimin e vendimeve te formes se prere e ka lejuar vetem ne raste rigorozisht te percaktuara, te cilat i ka parashikuar, ne menyre te shprehur, ne nje dispozite te posacme te K.Pr.Penale, konkretisht ne nenin 450 te tij, te cilen e ka emertuar "Rastet e rishikimit".

Sipas kesaj dispozite, rishikimi mund te kerkohet nga palet vetem neqoftese ekziston ndonjeri prej shkaqeve te parashikuara shprehimisht ne te dhe per asnje shkak dhe rast tjeter. Shkaqe te tilla jane: a) kur faktet e vena ne themel te vendimit nuk pajtohen me ato te nje vendimi tjeter te formes se prere; b) kur vendimi eshte bazuar ne nje vendim te gjykates civile, i cili eshte revokuar me pas; c) kur pas vendimit kane dale ose jane zbuluar prova te reja, te cilat vetem ose se bashku me ato qe jane vleresuar nje here, tregojne se vendimi eshte i gabuar dhe ç) kur vertetohet se vendimi eshte dhene si pasoje e falsifikimit te akteve te gjykimit, ose te nje fakti tjeter te parashikuar nga ligji si veper penale.

Ekzistenca, qofte edhe vetem e njerit prej ketyre rasteve, sherben si shkak per te kerkuar rishikimin e nje vendimi penal te formes se prere.

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, konstatojne se, ne praktiken e deritanishme, pas hyrjes ne fuqi te K.Pr.Penale, rishikimi eshte kerkuar nga palet, (kryesisht nga i denuari ose perfaqesuesi i autorizuar prej tij), me pretendimin se, pasi vendimi i dhene ka marre forme te prere, kane dale ose jane zbuluar prova te reja dhe per kete eshte pretenduar se vendimi eshte i gabuar dhe duhet te rishikohet.

Gjate gjykimit te ketyre kerkesave, qofte ne dhomen e keshillimit (kur eshte vendosur mospranimi) ashtu edhe gjate shqyrtimit gjyqesor (kur kerkesat jane pranuar dhe çeshtja eshte rigjykuar) jane konstatuar interpretime te ndryshme ne lidhje me faktin se çdo te kuptohet me "prova te reja", si dhe se kur do te quhet se ato kane dale ose zbuluar pas dhenies se vendimit. Per rrjedhoje, jane mbajtur

qendrime te ndryshme, shpesh edhe kontradiktore, sikurse ka ndodhur edhe midis qendrimeve qe jane mbajtur nga gjykata e rrethit gjyqesor dhe ajo e apelit Shkoder, ndaj kerkeses se perfaqesuesve te te denuarit Edmir Gjokicaj, çeshtje qe ka ardhur per zgjidhje dhe unifikim ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte.

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte arriten ne perfundimin se vendimi nr. 197, date 21.12.2001, i Gjykates se Apelit Shkoder eshte i gabuar, pasi eshte marre ne kundershtim me ligjin. Nga ana e kesaj gjykate eshte interpretuar gabim kuptimi i permbajtjes se shkronjes "c", te nenit 450 te K.Pr.Penale, pasi kerkesa per rishikim qe eshte paraqitur nga perfaqesuesit e te denuarit Edmir, edhe sikur te mos ekzistonin parregullsite qe u permenden ne pjesen e pare te ketij vendimi, nuk i plotesonte kushtet per t'u konsideruar si nje nga rastet qe ligjvenesi ka parashikuar se mund te kerkohet rishikimi i vendimeve penale te formes se prere.

Deklaratat e leshuara nga tre shtetas te ndryshem nuk mund te konsiderohen prova, ashtu sikurse kerkohet, ne forme qartesisht te shprehur, ne shkronjen "c" te nenit 450 te K.Pr.Penale.

Si shkresat, dokumentat, ashtu edhe objektet te natyres materiale, per t'u paraqitur si shkak per rishikimin e vendimit duhet te plotesojne bashkerisht dy kushte: se pari, te kene dale ose te jene zbuluar pasi vendimi kishte marre forme te prere dhe se dyti, nga pikepamja e formes proceduriale, te jene prova, ne kuptimin qe i jep proves ligjvenesi ne dispoziten e nenit 149 te K.Pr.Penale.

Ato, jo vetem qe duhet te permbajne njoftime mbi faktet e rrethanat qe lidhen me vepren penale per te cilat eshte deklaruar fajtor dhe denuar personi, por edhe te jene marre nga njeri prej burimeve te parashikuara ne ligjin procedurial penal, ne perputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe qe sherbejne per te vertetuar moskryerjen prej tij te vepres penale, kerkesa keto qe nuk i plotesojne deklaratat e paraqitura si shkak per rishikim ne rastin konkret.

Fakti qe, pasi jane leshuar, ato u autentifikuan nga ana e nje noteri, ashtu edhe sikurse ato te ishin redaktuar teresisht prej tij (noterit) nuk sjell asnje ndryshim ne ato qe u thane me lart, pasi deklarimet e bera para nje noteri nuk u japin atyre cilesine e proves ne kuptimin e nenit 149 te K.Pr.Penale.

Ne lidhje me ceshtjen tjeter qe shtrohet per unifikim para Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte dhe qe ka te beje me shprehjen e perdorur nga ligjvenesi: " Kur pas vendimit, kane dale, ose jane zbuluar prova te reja…", duhen patur parasysh edhe ato prova qe nuk jane shqyrtuar gjate gjykimit dhe qe nuk jane kerkuar nga palet, megjithese diheshin prej tyre, apo vetem ato qe jane zbuluar pas dhenies se vendimit, me kusht qe pala qe e kerkon te mos kish dijeni per ekzistencen e tyre, kolegjet, arriten ne perfundimin se prova qe sherben si shkak per rishikim duhet te jete e re, ne kuptimin qe ajo te kete dale ose te jete zbuluar pasi vendimi te kete marre forme te prere.

Ne lidhje me kete ligjvenesi ka perdorur shprehjet: "… kane dale" ose "jane zbuluar". Kuptimi i ketyre dy shprehjeve, nga pikepamja e qellimit te perdorimit te tyre, ne permbajtjen e shkronjes "c" te nenit 450 te K.Pr.Penale, eshte i njejte. Ne te dy rastet behet fjale per prova, te cilat, megjithese kane ekzistuar objektivisht ne kohen kur u shqyrtua ceshtja, ato nuk ishin paraqitur nga palet deri ne momentin qe vendimi ka marre forme te prere, pasi ekzistenca e tyre nuk dihej, deri atehere, prej tyre (paleve). Mosdijenia e paleve per ekzistencen e ketyre provave, ne keto raste e ka burimin ose ne mosthellimin e tyre ne procesin e zbulimit ose ne pamundesine dhe pengesat reale qe ato mund te kene hasur gjate ketij procesi.

Veshtiresite dhe pengesat ne keto raste mund ta kene burimin sa ne mosthellimin dhe mungesat profesionale te personave qe jane te ngarkuar me zbulimin dhe administrimin e provave, te nje vepre penale, aq edhe ne veprimtarine keqberese te personave te interesuar, per fshehjen, prishjen dhe manipulimin e tyre.

Dallimi midis shprehjeve "… kane dale…" dhe "… jane zbuluar", konsiston ne faktin se shprehja e pare perdoret ne rastin kur ekzistenca e provave te reja qe kane lidhje me nje vendim penal te formes se prere te meparshem evidentohet gjate nje procesi hetimor ose gjyqesor tjeter, i cili nuk ka lidhje me ceshtjen per te cilen eshte dhene vendimi qe kerkohet te rishikohet dhe jane fiksuar ne aktet procedurale (proces-verbalet) e dosjes perkatese. Kurse e dyta, kur palet e interesuara, per te verifikuar pretendimet ose dyshimet e tyre ne lidhje me vertetesine dhe drejtesine e vendimit te dhene, kryejne veprimtari verifikuese, mbasi ky vendim ka marre formen e prere.

Duke u bazuar ne sa u tha me lart, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte arriten ne perfundimin se provat qe diheshin prej paleve, qe para se vendimi te merrte formen e prere, nuk mund te konsiderohen prova te reja, ne kuptim te shkronjes "c" te nenit 450 te K.Pr.Penale, pavaresisht nga arsyeja e mosparaqitjes se tyre ne ate kohe.

PER KETO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte bazuar ne nenin 441/c te K.Pr.Penale,

V E N D O S E N:

Prishjen e vendimit nr. 197, date 21.12.2001, te Gjykates se Apelit Shkoder dhe lenien ne fuqi te vendimit nr. 256, date 22.10.2001, te Gjykates se rrethit gjyqesor Shkoder.

Ky vendim unifikues te dergohet per botim ne Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICES

Kemi mendimin se trajtimi i problemit dhe per pasoje zgjidhja e çeshtjes me vendimin e shumices nuk eshte i drejte.

Vendosja e institutit te "rishikimit" ne K.Pr.Penale miratuar me ligjin nr. 7905 date 21.3.1995, i cili ne vetvete eshte nje mjet i rendesishem ankimi qe jep mundesine per rivendosjen e nje te drejte qe mund te jete shkelur, krijoi hapesire per palet ne gjykim qe ta ushtrojne kete te drejte ne perputhje me kriteret e percaktuara. Ky institut parashikohet ne kreun e IV te Kodit Penal ne 13 nene. Neni 449 percakton ne piken 1 se " ne rastet e caktuara me ligj lejohet ne cdo kohe rishikimi i vendimit qe ka marre formen e prere, edhe kur denimi eshte ekzekutuar ose eshte shuar" dhe ne piken 2 "vendimet e pafajesise per krime mund te rishikohen me kerkesen e prokurorit, por me kusht qe te mos kene kaluar 5 vjet nga dhenia e vendimit".

Nga permbajtja e ketij neni dhe e nenit 451 te K.Pr.Penale del qarte se kerkesa per rishikim mund te behet nga i denuari ose kujdestari i tij (dhe kur ai ka vdekur nga trashegimtari apo nje i aferm i tij) dhe nga prokurori prane gjykates qe ka dhene vendimin.

Pa dashur te trajtojme gjithe problemet qe parashikohen per rishikimin ne K.Pr.Penale, ashtu siç u trajtua ne shqyrtimin e ceshtjes nga Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, problemin baze e perben neni 450 i K. Pr. Penale qe parashikon se kur mund te kerkohet rishikimi. Rastet qe parashikohen ne germen "a", "b" te atij neni, jane te kuptueshme dhe nuk kane lindur probleme ne praktike (kur faktet e vena ne themel te vendimit nuk pajtohen me ato te nje vendimi tjeter te formes se prere dhe kur vendimi eshte bazuar ne nje vendim te gjykates civile, i cili eshte revokuar me pas). Po e njejta gje duhet thene edhe per rastin e parashikuar ne piken "ç" (kur vertetohet se vendimi eshte dhene si pasoje e falsifikimit te akteve te gjykimit ose te nje fakti tjeter te parashikuar nga ligji si veper penale).

Probleme kane lindur ne vazhdimesi ne praktiken gjyqesore lidhur me zbatimin e rasteve qe parashikohen ne germen "c" te nenit 450 te K.Pr.Penale ku thuhet:

"Kur pas vendimit kane dale ose jane zbuluar prova te reja, te cilat vetem ose se bashku me ato qe jane vleresuar njehere, tregojne se vendimi eshte i gabuar".

Nga permbajtja e kesaj germe dalin disa probleme si :

a. ç'duhet te kuptohet me termat "kane dale ose jane zbuluar prova te reja";

b. po termi prova te reja ne kete rast si duhet kuptuar, ne çforme do te merret, kush do ta marre, ne ç'forme do t'i paraqitet gjykates?

Duke qene nje mjet i vecante ankimi (por shume i rendesishem ne disa raste per menjanimin e shkeljeve qe kane sjelle si pasoje marrjen e nje vendimi penal gjyqesor jo te bazuar) dhe nga permbajtja qe ka neni 450, del qarte se rastet e ushtrimit te kesaj te drejte jane te kufizuara. Kryesisht, ne praktiken e gjykatave, vihet re se kerkesa per rishikim te vendimeve jane bere vetem ne mbeshtetje te germes "c" dhe per kete qellim nga te pandehurit apo mbrojtesit e tyre jane marre deklarata me shkrim nga persona qe

kane paraqitur rrethana te reja te ndryshme nga ato qe jane marre ne gjykimin e ceshtjes e qe vene ne dyshim permbajtjen e atij vendimi gje qe, nese e cmon e pranon gjykata, mund te sherbeje si baze per rishikimin apo dhe prishjen e nje vendimi gjyqesor te dhene me pare.

Per te ruajtur autenticitetin dhe saktesuar identifikimin e personave qe tregojne rrethana te reja, keto deklarime jane bere para noterit (gje qe tregon edhe faktin se i pandehuri apo mbrojtesi i tij ne kete menyre kerkojne te rritin pergjegjesine e personit qe ka bere deklarime e qe ato me pas, ne gjykim, te mos shtremberohen), dhe i jane paraqitur gjykates si prova te reja. Gjykatat jane shprehur per pranimin apo jo te kerkeses per rishikim mbi keto deklarata.

Me te drejte Kolegji Penal i Gjykates se Larte, duke ndjekur praktiken gjyqesore, e ka derguar kete ceshtje per shqyrtim dhe unifikim te praktikes ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte. Kjo per faktin qe u shtrua ne forme pyetjeje edhe me lart se çduhet kuptuar “me prova te reja e si do te merren keto” sepse ne kuptimin e mirefillte te fjales vete deklaratat qofshin apo jo te bera para noterit nuk mund te trajtohen si prova.

Rendesia e ketij vendimi unifikues ka vlerat e tij pavaresisht nga fakti se me ndryshimet e bera ne K.Pr.Penale me ligjin nr. 8813 date 13.6.2002 kompetente per gjykimin e kerkesave per rishikim eshte Gjykata e Larte. Kjo jo vetem per faktin e dhenies se vendimeve te drejta por edhe per te menjanuar rastet e berjes se kerkesave pa plotesuar kriteret per pranimin e tyre.

Ne kete apekt jemi me te njejtin mendim te shumices per nevojen e unifikimit te praktikes. Po keshtu jemi me te njejtin mendim lidhur me te drejten e prokurorit per te bere ankim kunder vendimit te marre nga gjykata me te cilin eshte pranuar kerkesa per rishikim (siç eshte ne rastin ne shqyrtim qe prokurori me rekurs kerkon prishjen e vendimit nr. 197 date 21.12.2001 te Gjykates se Apelit Shkoder me te cilin eshte vendosur prishja e vendimit te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Shkoder, pranimi i kerkeses se Edmir Gjokicajt per rishikim dhe kthimin e akteve gjykates se shkalles se pare per shqyrtimin e çeshtjes).

Sikurse permendem, eshte e nevojshme te dale qarte se çduhet kuptuar me shprehjen qe percakton germa “c” e nenit 450 te K.Pr.Penale “kane dale ose jane zbuluar prova te reja”. Kuptohet qarte se pari se pala qe kerkon rishikimin (i pandehuri apo prokurori) eshte e domosdoshme qe te paraqese prova te reja pra qe te mos jene administruar e mos i jene nenshtruar shqyrtimit me pare nga gjykata dhe qe te jete zbuluar mbas dhenies se nje vendimi penal qe ka marre forme te prere. Ne kete aspekt duhet pranuar se nuk mund te perbeje prove te re per te rishikuar vendimin nje prove qe eshte kerkuar gjate gjykimit te ceshtjes por qe per arsye te ndryshme nuk eshte marre nga gjykata dhe qe paraqet vlera provuese.

Nocionet “kane dale” ose “ jane zbuluar prova te reja” behen te qarta e te kuptueshme edhe nga vete termat qe perdoren por problemi kryesor qe shtrohet per diskutim e zgjidhje eshte se çduhet kuptuar me termin “prova te reja” e si do te merren ato.

Shumica ka mendimin se shkresat, dokumentat apo objektet e natyres materiale mund te paraqiten per rishikimin e vendimit vetem ne rast se ato marrin cilesine e proves sipas percaktimeve te bera ne K.Pr.Penale. Ne nenin 149 te K.Pr.Penale thuhet: “prova jane njoftimet mbi faktet e rrethanat qe lidhen me vepren penale, qe merren prej burimeve te parashikuara ne ligjin procedurial penal, ne perputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe qe sherbejne per te vertetuar kryerjen ose jo te vepres penale, pasojat e ardhura prej saj, fajesine ose pafajesine e te pandehurit dhe shkallen e pergjegjesise se tij”, ndersa ne nenin 151 thuhet se “gjate hetimeve paraprake provat merren nga organi qe procedon” e “ne gjykim provat merren me kerkesen e paleve”.

Duke mos e pare te nevojshme te trajtojme llojet e provave qe parashikohen ne Kreun e II te K.Pr.Penale kemi mendimin se ne se do te zbatohet mendimi i shumices per menyren e marrjes se proves, çdo i pandehur apo mbrojtes do te vihej ne pamundesi te plote per te ushtruar te drejten e rishikimit. Ne se do te pranohej qe prove eshte ajo qe merret nga organi qe procedon apo nga gjykata, atehere shtrohet pyetja: si do te merren prej tyre ato fakte qe i pandehuri pretendon t’i paraqese si prova te reja? A kane ndonje detyrim ligjor organi i procedimit dhe gjykata te marrin me cilesine e proves ato qe paraqet i pandehuri me qellim per te rishikuar nje vendim te formes se prere? Keto organe jo vetem qe s’kane asnje detyrim por edhe provat merren prej tyre “gjate hetimeve paraprake” dhe “ne gjykim”. Duke ju referuar ketyre percaktimeve ligjore nuk do te ndodheshin para minimizimit te rasteve te rishikimit te vendimeve penale te formes se prere, por para moszbatimit teresor te germes “c” te nenit 450 te K.Pr.Penale.

Theksuam se ne praktike jane pranuar per tu diskutuar si prova ne gjykim deklaratat e leshuara nga persona te ndryshem (noteriale apo te thjeshta) te cilat i jane nenshtruar vleresimit te gjykates ne se jane te mjaftueshme apo jo per tu pranuar te merren si prova. Edhe Kolegji Penal i Gjykates se Larte, ne ato pak raste qe ka shqyrtuar mbi rekurset e ushtruara, eshte bazuar ne po ato deklarata.

Nese do tu qendronim strikt termave qe jep neni 450/c i K.Pr.Penale eshte e nevojshme qe te jepen edhe rruget se si do te gjeje zbatim ai nen e nese shihet se nuk hapet horizont edhe me vendimin e shumices, ne se duhet qe ai te zbatohet, te studiohet mundesia e permiresimit apo ndryshimit te ligjit gje qe do te ishte me e drejte dhe aspak e kontestuar.

Ne rastin ne shqyrtim, Gjykata e Apelit Shkoder, ne marrjen e vendimit per pranimin e kerkeses per rishikim te Edmir Gjokicajt, ka marre per baze deklaratat noteriale te paraqitura prej tij, gje qe bazohet ne eksperiencen dhe praktiken shumevjecare te gjykatave te rrethit, te apelit e te Gjykates se Larte. Per rrjedhoje, vendimi duhet te trajtohet per kohen qe eshte marre e nje vendim gjykate qofte ky edhe unifikues i Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte nuk mund te shtrije e te kete efekte prapavepruese por unifikon praktiken qe duhet te zbatohet ne te ardhmen. Per pasoje mendojme se nuk eshte i drejte edhe vendimi i marre per prishjen e vendimit te Gjykates se Apelit Shkoder.

GJYQTARET
V. KONDILI, Y. MYRTJA, K. NGJELA , A.LAMAJ, N. KITA, V. METANI , Z. PODA, V. BINERI

V E N D I M
Nr. 7, datë 11.10.2002

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte te perbere nga:

Thimjo KondiKryesues	Metush Saraçi “
Perikli ZahariaAnetar	Valentina Kondili “
Kristaq Ngjela “	Vladimir Metani “
Ylvi Myrtja “	Vladimir Bineri “
Agron Lamaj “	Zamir Poda “
Natasha Sheshi “	Bashkim Caka “
Nikoleta Kita “	Evgjeni Sinoimeri “
Spiro Spiro “	Irma Bala “
Artan Hoxha “	

ne seancen gjyqesore te dates 11.10.2002, moren ne shqyrtim ceshtjen penale nr. 8, qe i perket:

TE DENUARIT: BLERIM LLUKANI

OBJEKTI I KERKESES: Mosekzekutim i vendimit penal te formes se prere, duke u perjashtuar nga vuajtja e metejshme e denimit, per shkak te parashkrimit dhe shuarjes se tij.

BAZA LIGJORE : Nenet 68/c te K.Penal si dhe 480 e vijues te K.Pr.Penale.

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Elbasan me vendimin nr. 114, date 30.10.2001 ka vendosur:

“Rrezimin e kerkeses se paraqitur nga i denuari Blerim Llukani me objekt mosekzekutimin e vendimit te denimit penal nr. 141 date 24.7.1996 te Gjykates se Rrethit Elbasan, per perjashtimin nga vuajtja e metejshme e denimit per shkak te parashkrimit dhe shuarjes se denimit, si te pabazuar ne ligj”.

Gjykata e Apelit Durres, mbi ankimin e te denuarit, me vendimin nr. 280 date 20.12.2001, ka vendosur:

“Lenien ne fuqi te vendimit Nr. 114 date 30.10.2001 te Gjykates se Rrethit Elbasan”.

Kunder vendimit te Gjykates se Apelit Durres dhe Gjykates Rrethit Gjyqesor Elbasan, ka paraqitur rekurs ne baze te nenit 432 te K.Pr.Penale i denuari Blerim Llukani, i cili kerkon prishjen e tyre dhe pranimin e kerkeses, duke parashtruar keto shkaqe:

Nga gjykatat eshte zbatuar gabim ligja, kur:

- Konform nenit 68 te K.Penal eshte parashkruar ekzekutimi i denimit, pasi nga dita qe vendimi ka marre forme te prere ka kaluar mbi 5 vjet.

- Ne kreun VIII te K.Penal, ku eshte dhe neni 68, por qe harmonizohet dhe me nenin 480 te K.Pr.Penale, gjithçka kufizohet taksativisht me afatet e shuarjes dhe parashkrimit te denimit, afate te cilat fillojne nga dita qe vendimi ka marre forme te prere.

- Ne K.Pr.Penale per keto afate nuk ka dhe nuk parashikohen pezullime apo nderprerje etj. per mosekzekutimin e denimit dhe per pasoje neni 68 i K.Penal ka karakter detyrues per tu zbatuar dhe nuk kushtezon kete ekzekutim vendimi, qe nuk eshte kryer per faj ose pakujdesi te organeve kompetente qe merren me kete ceshtje.

- Ligja mund te kete vakume ligjore, por ligji nr. 8202 date 27.3.1997 dhe ligji nr. 8268 date 22.12.1997 "Per amnistine" nuk ndryshuan nenin 68 te K.Penal, per te pezulluar apo nderprere ekzekutimin e vuajtjes se denimit per shkak te hapjes se burgjeve, i cili nuk u be per faj te te denuarve.

KOLEGJET E BASHKUARA TE GJYKATES SE LARTE,

Pasi degjuan relacionin e anetareve Ylvi Myrtja e Vladimir Bineri,

pasi degjuan prokurorin e Prokurorise se Pergjithshme Artur Selmani, qe kerkoi prishjen e vendimit te gjykates se shkalles se pare dhe te gjykates se apelit dhe pranimin e kerkeses se te denuarit,

pasi degjuan avokatin e te denuarit z. Hysen Kovaci, i cili kerkoi prishjen e vendimit te gjykates se shkalles se pare dhe te gjykates se apelit dhe pranimin e kerkeses,

V E R E J N E:

Me vendim Nr. 141 date 24.7.1996 te Gjykates se Rrethit Elbasan eshte vendosur: "Deklarimi fajtor i te pandehurit Blerim Llukani per vepren penale te vjedhjes me dhune ne bashkepunim dhe ne baze te neneve 139 e 25 dhe 50/gj te K.Penal e 406 te K.Pr.Penale eshte denuar me 6 vjet burgim, duke i filluar vuajtja e denimit nga data e arrestimit 17.12.1995". Ky vendim, ne baze te vendimit nr.707 date 11.9.1996 te Gjykates se Apelit Tirane, eshte lene ne fuqi, duke u ndryshuar vetem masa e denimit te te gjykuarit nga 6 vjet ne 4 vjet burgim.Vendimi i gjykates se apelit eshte lene ne fuqi me vendimin nr. 333 date 4.12.1997 te Kolegjit Penal te Gjykates se Kasacionit.

Organi i Prokurorise Elbasan, ne baze te nenit 464/3 te K.Pr.Penale, me date 8.10.1996 ka nxjerr urdherin per ekzekutimin e vendimit penal nr.141.Vuajtja e denimit per te denuarin, ashtu sic eshte shprehur dhe gjykata ne vendimin e saj, por dhe ne urdherin e ekzekutimit te prokurorit, ka filluar me date 17.12.1995. I denuari ka filluar vuajtjen e denimit ne Institucionin e Riedukimit 325 Tirane deri me date 13.3.1997, dite kur vuajtja e metejshme e denimit eshte nderprere nga trazirat ne vend. Pas kesaj date i denuari nuk eshte kthyer vullnetarisht me per vazhdimin e metejshem te vuajtjes se denimit penal dhe as eshte bere e mundur rivenia ne ekzekutim e denimit, duke ngelur pa vuajtur ende 2 vjet, 4 muaj e 22 dite burgim.

I denuari ne kerkesen e tij drejtuar gjykates kerkon mosekzekutimin e metejshem te vuajtjes se denimit ne baze te nenit 68 te K.Penal, me pretendimin se ai eshte parashkruar sepse kane kaluar 5 vjet nga dita qe vendimi ka marre forme te prere, pra nga data 11.9.1996.

Gjykata e rrethit gjyqesor Elbasan ka rrezuar kerkesen e tij dhe vendimi eshte lene ne fuqi nga Gjykata e Apelit Durres, me arsyetimin se instituti i shuarjes se denimit dhe mos ekzekutimit te vendimeve penale per shkak te parashkrimit, ben fjale per vendime penale, te cilat nuk jane vene ne ekzekutim dhe jo per vendime penale qe kane filluar te ekzekutohen.

Kolegji Penal i Gjykates se Larte me vendimin nr. 279 date 18.04.2002 ka vendosur kalimin e ceshtjes ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte per unifikimin e praktikes gjyqesore.

Problemet ligjore, te cilat duhet te gjejne nje trajtim juridik, ne kete ceshtje jane :

Kur eshte i zbatueshem instituti i parashkrimit te ekzekutimit te denimit :

a) vetem ne rast se vendimi penal nuk eshte vene asnjehere ne ekzekutim;

b) apo edhe ne rastet kur vendimi eshte vene ne ekzekutim dhe nuk eshte permbushur plotesisht;

c) a do te pranohet koncepti i nderprerjes dhe i pezullimit te parashkrimit te ekzekutimit te denimit?

Kolegjet e Bashkuara çmojne se vendimet e te dy gjykatave nuk jane te drejta, pasi ato nuk trajtojne si duhet kuptimin e institutit te parashkrimit te denimit parashikuar nga neni 68 i Kodit Penal.

Ne kete perfundim Kolegjet e Bashkuara edhe pse deri tani nuk ka patur jurisprudence ne lidhje me kete ceshtje, arriten duke u nisur nga interpretimi i gjithanshem qe u "kane" bere dispozitave te Kodit Penal ne lidhje me parashkrimin.

Ne kreun e VIII-te te Kodit Penal ligjvenesi ka parashikuar nje institut me vete ne lidhje me shuarjen e ndjekjes penale, te denimeve dhe mosekzekutimin e tyre.

Brenda kuadrit te ketij instituti jane perfshire dispozita te vecanta ne lidhje me parashkrimin e ndjekjes penale, (neni 66 i K.Penal); ne lidhje me parashkrimin e ekzekutimit te denimit, (neni 68 i Kodit Penal) dhe shuarjen e denimit ose, sikurse e ka emertuar vete ligjvenesi, rehabilitimin, (neni 69 i Kodit Penal).

Keto dispozita permbajne rregullimin ligjor te ketij instituti ne tre aspekte te vecanta te tij.

Keshtu, dispozita e nenit 66 te Kodit Penal ben fjale per parashkrimin e ndjekjes penale me te cilin duhet kuptuar ndalimi qe ekziston me ligj per te bere ndjekje penale, ne qofte se, nga koha kur eshte kryer vepra penale, deri ne momentin e marrjes si te pandehur te autorit te saj, kane kaluar afatet e parashikuara ne kete dispozite.

Ne dispoziten e nenit 68 te Kodit Penal ligjvenesi ka parashikuar afatet, me kalimin e te cileve, vendimi i denimit, dhene ndaj nje personi per vepra penale te kryera prej tij, nuk mund te ekzekutohet me.

Kurse ne dispoziten e nenit 69 te Kodit Penal jane parashikuar afatet, me kalimin e te cileve, personi i denuar per vepra penale te kryera prej tij, do te quhet i padenuar ose, sic e ka vete ligji i rehabilituar.

Nga sa u parashtrua shkurtimisht me lart, arrihet ne perfundimin se, ne rastin e pare, (neni 66 i Kodit Penal) ndodhemi para rastit te parashkrimit te se drejtes se organeve kompetente te ndjekjes penale; ne rastin e dyte (neni 68 i Kodit Penal), ndodhemi para parashkrimit te se drejtes se organeve kompetente shteterore, te ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve te denimit per te ekzekutuar keto vendime. Kurse, ne rastin e trete, (neni 69 i Kodit Penal) ndodhemi para shuarjes se denimit te dhene ndaj nje personi per vepra penale te kryera prej tij dmth, para rehabilitimit te ketij personi qe sjell si pasoje ndryshimin e gjendjes gjyqesore te tij, nga i denuar ne i padenuar.

Çeshtja objekt gjykimi ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte ka te beje me aspektin e dyte te institutit te parashkrimit, dmth me parashkrimin e ekzekutimit te denimit, parashikuar nga neni 68 i Kodit Penal.

Nga permbajtja e kesaj dispozite, del se vendimi i denimit nuk ekzekutohet kur nga dita qe ka marre forme te prere kane kaluar : njezet vjet per vendimin qe permban denim pesembedhjete gjer ne njezetepese vjet; dhjete vjet per vendimin qe permban denim pese gjer ne pesembedhjete vjet dhe pese vjet per vendime qe permbajne denim me burgim gjer ne pese vjet ose denime te tjera me te lehta.

Duket qarte se, ligjvenesi, nepermjet kesaj dispozite, ka vene perpara organeve kompetente shteterore te ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve te denimit nje kufizim kohor brenda te cilit keto organe kane te drejte qe te vene ne ekzekutim nje vendim penal te formes se prere. Ky kufizim kohor, perben ne te njejten kohe edhe nje ndalim te shprehur per keto organe, i cili nuk u lejon atyre qe te ekzekutojne vendime penale tej afateve te percaktuara, sipas rastit, ne shkronjat "a", "b" dhe "c" te dispozites se nenit 68 te Kodit Penal.

Qellimi i ligjvenesit ne vendosjen e ketij kufizimi kohor dhe ndalimi ka qene se pari, realizimi ne praktike i efektit te pergjithshem dhe te vecante parandalues te denimit ne cdo rast konkret dhe se dyti, disiplinimi i procesit te ekzekutimit te vendimeve te denimit ne pergjithesi dhe ne menyre te vecante ne rastet kur personi i denuar, per njeren apo tjetren arsye i shmanget apo i fshihet ketij procesi.

Te drejten dhe njekohesisht detyren qe kane organet kompetente shteterore, te ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve te denimit, ligjvenesi e ka kushtezuar se pari me momentin kur vendimi i denimit ka marre formen e prere dhe se dyti, ne vartesi te masave dhe llojeve te denimit te dhene, me

afatet, (njezet, dhjete dhe pese vjet), qe parashikohen ne dispoziten e permendur te Kodit Penal.

Nga sa u parashtruan ne paragrafin e mesiperm, arrihet ne perfundimin se, organet kompetente shteterore te ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve te denimit, kane te drejte dhe njekohesisht detyre qe menjehere, sapo vendimi i denimit te kete marre forme te prere, ta vene ne ekzekutim ate.

Kete te drejte ato vazhdojne ta kene derisa pa u plotesuar akoma afatet, njezet, dhjete dhe pese vjet te parashikuara respektivisht nga shkronjat "a", "b" dhe "c" te nenit 68 te Kodit Penal.

Nga kjo del se vendimi i denimit nuk mund te ekzekutohet as para se ai te kete marre forme te prere, as pasi te jene plotesuar afatet njezete, dhjete dhe pese vjet qe u permenden dhe kjo perben ndalimin qe u permend me lart.

I denuari Blerim Llukani eshte denuar me vendimin nr. 141 date 24.7.1996 te Gjykates se shkalles se pare Elbasan. Vendimi i dhene nga Gjykata e Elbasanit ka marre forme te prere me date 11.9.1996 diten kur ka shpallur vendimin e saj gjykata e apelit. Denimi i dhene per te denuarin Blerim Llukani ka qene me i ulet se 5 vjet burgim.

Me kalimin e pese vjeteve e konkretisht me 12.9.2001 i denuari Blerim Llukani ka hartuar dhe depozituar ne Gjykaten e rrethit Elbasan kerkesen objekt gjykimi me pretendimin se vendimi i denimit te dhene kunder tij nuk mund te ekzekutohej me per faktin se kishin kaluar pese vjet nga dita qe vendimi kishte marre forme te prere. Nepermjet kerkeses objekt gjykimi i denuari ka kerkuar nga gjykata deklarimin si te parashkruar te denimit te dhene kunder tij. Kerkimet i denuari perveç nenit 68 te Kodit Penal te analizuar me siper i bazon edhe ne nenet 470, 471 e 480 te Kodit te Procedures Penale.

Dispozitat proceduriale te sipercituara sanksionojne gjykaten kompetente ne fazen e ekzekutimit (neni 470 i K.Pr.Penale) menyren e procedimit (neni 471 i K.Pr.Penale) dhe kompetencat e gjykates (neni 480 i K.Pr.Penale). Sipas nenit 480 te K.Pr.Penale: "Ne fazen e ekzekutimit, gjykata eshte kompetente te vendose per shuarjen e vepres penale pas denimit, per shuarjen e denimit, per denimet plotesuese, per konfiskimin dhe kthimin e sendeve te sekuestruara, si dhe per çdo rast te parashikuar me ligj".

Ne kundershtim me sa u analizua me siper, gjykatat e kane rrezuar padrejtesisht kerkesen e te denuarit Blerim Llukani megjithese kishin kaluar pese vjet nga dita qe vendimi kishte marre forme te prere. Me kalimin e pese vjeteve vendimi i denimit nuk mund te ekzekutohet (neni 68/c i Kodit Penal). Si gjykata e shkalles se pare dhe ajo e apelit ishin te detyruara te deklaronin se denimi i dhene kunder te denuarit Blerim Llukani nuk mund te ekzekutohej me per faktin se ai ishte parashkruar.

Nga leximi i vete tekstit te dispozites se nenit 68 te Kodit Penal shihet fare qarte qe ligjvenesi jo vetem qe nuk ka parashikuar, por as ka lene te nenkuptohet se ekzistojne shkaqe apo faktore qe mund te sjellin si pasoje zgjatjen e afateve te parashkrimit qe jane parashikuar prej tij ne lidhje me ekzekutimin e vendimit te denimit.

Gjykata e shkalles se pare Elbasan dhe Gjykata e Apelit Durres e kane rrezuar kerkesen e te denuarit Blerim Llukani me arsyetimin: "se me date 13.3.1997 eshte nderprere vuajtja e denimit". Ky konkluzion i gjykatave nuk gjen mbeshtetje ne asnje dispozite ligjore te se drejtes penale. Ne Kodin Penal dhe ne Kodin e Procedures Penale nuk parashikohet nderprerja e ekzekutimit te vendimeve. Megjithese ne legjislacionin penal shqiptar nuk parashikohet nderprerja e ekzekutimit te vendimit, gjykatat i referohen parimeve te pergjithshme te se drejtes e sidomos te drejtes civile qe e parashikon nderprerjen si nje institut ligjor. Nje qendrim i tille vjen ne kundershtim me parimet e Kodit Penal shqiptar. Ne te drejten penale shqiptare eshte sanksionuar: "Kodi Penal bazohet ne parimet kushtetuese te shtetit te se drejtes, te barazise perpara ligjit, te drejtesise ne caktimin e fajesise dhe te denimit, si dhe te humanizmit. Zbatimi i ligjit penal me analogji nuk lejohet.

Siç shihet menyra e arsyetimit qe mbeshtetet ne disa parime te pergjithshme per te nxjerr perfundime te njejta eshte kategorikisht e ndaluar per te drejten penale. Per kete arsye ligjvenesi ka sanksionuar ne Kodin Penal parimin e moszbatimit te ligjit penal me analogji (neni 1/c i Kodit Penal).

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte arriten ne perfundimin se edhe duke u nisur nga interpretimi logjik i shprehjes se perdorur nga ligjvenesi ne dispoziten e ketij neni ku thuhet: "Vendimi i denimit nuk ekzekutohet kur nga dita qe ka marre forme te prere kane kaluar…", nuk mund te kete zgjatje te afateve te parashkrimit te ekzekutimit te denimit per asnjelloj shkaku. Kjo vlen si per rastet kur vendimi i denimit nuk eshte vene fare ne ekzekutim, ashtu edhe per rastet kur ky vendim eshte vene ne ekzekutim

dhe pasi i denuari ka filluar te vuaje denimin, vuajtja e metejshme e tij nderpritet per cfaredolloj shkaku, sikurse mund te jete edhe largimi i te denuarit nga vuajtja e denimit, sic ka ndodhur me te denuarin Blerim Llukani.

Fakti qe vendimi i denimit qe i perket ketij te denuari ishte vene ne ekzekutim dhe ai, deri me 13.3.1997 kur u largua nga vendi i vuajtjes se denimit, kishte vuajtur rreth 21 muaj nga denimi i dhene, nuk mund te sherbeje si rrethane per t'i bere dispozites se nenit 68 te Kodit Penal nje interpretim te ndryshem nga ai qe i u be nga Kolegjet e Bashkuara, ne pjeset e meparshme te ketij vendimi.

Vetem fakti, qe i denuari Blerim ka vuajtur nje pjese te denimit nuk mund ta vendos ate ne pozita me te disfavorshme ne raport me cdo te denuar tjeter, vendimi penal ndaj te cilit nuk eshte vene ende ne ekzekutim. Ishte detyra e organeve kompetente shteterore, te ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve penale qe te merrte masat e duhura per te gjetur dhe kapur kete te denuar dhe per ta detyruar ate qe te vazhdonte vuajtjen e metejshme te denimit. Per kete kategori te denuarish duhet te aplikohet i njejti rregull. Nisur nga parimi i barazise para ligjit (neni 18 i Kushtetutes) instituti i parashkrimit te ekzekutimit te denimit duhet te zbatohet njelloj per te gjithe te denuarit, si per ata ekzekutimi ndaj te cileve nuk ka filluar si dhe per ata ekzekutimi ndaj te cileve nuk eshte permbushur plotesisht. Eshte e padrejte qe te perfitoje nje person qe nuk ka vuajtur as nje dite burg dhe te mos perfitoje nje person qe ka vuajtur nje pjese te denimit. Ne favor te ketij konkluzioni shkon dhe fakti se qellimi i institutit te parashkrimit te ekzekutimit te denimit eshte i njejte per te gjithe shtetasit, te cilet jane denuar penalisht me burgim.

PER KETO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte ne baze te nenit 442 te Kodit te Procedures Penale,

V E N D O S E N:

Prishjen e vendimit nr. 114 date 30.10.2001 te Gjykates se rrethit gjyqesor Elbasan dhe vendimit nr. 280 date 20.12.2001 te Gjykates se Apelit Durres, pranimin e kerkeses se te denuarit Blerim Llukani duke deklaruar denimin e tij te shuar.

Ky vendim per unifikimin e praktikes gjyqesore dergohet per botim ne Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, në kreun e tetë të tij, nën titullin e përbashkët "Shuarja e ndjekjes penale, e dënimeve dhe mosekzekutimi i tyre", parashikon dhe rregullon edhe parashkrimin e ekzekutimit të dënimit penal.

Parashkrimi i ekzekutimit të dënimit penal, si çdo rast tjetër parashkrimi, përmban dy elemente: 1. mosveprimin e shtetit për të realizuar një të drejtë e përmbushur një detyrim (ekzekutimin e vendimit të dënimit penal); 2. afatin kohor pas kalimit të të cilit organi i ekzekutimit nuk mund të kryejë më veprime ekzekutimi.

Pas kalimit të afatit të parashkrimit nuk shuhet automatikisht vetë dënimi, sepse personi përkatës vazhdon të quhet i dënuar (nuk quhet i rehabilituar). Afati i rehabilitimit, sipas nenit 69 të Kodit Penal, fillon të ecë kur i dënuari e ka përfunduar vuajtjen e dënimit. Me momentin e përfundimit të vuajtjes së dënimit barazohet për këtë efekt edhe momenti kur dënimi nuk mund të vazhdojë të vuhet më për çfarëdo lloj shkaku të përligjur.

Shumica ka arritur në përfundimin se, në rastin në shqyrtim, afati 5-vjeçar i parashkrimit të ekzekutimit të vendimit të dënimit ka filluar kur vendimi ka marrë formë të prerë (datë 11.9.1996) dhe se në kohën kur është gjykuar kërkesa në gjykatën e shkallës së parë, e për më tepër në gjykatën e apelit, ky afat ka qenë i plotësuar.

Shumica ka arritur në këtë përfundim duke arsyetuar se "në Kodin Penal dhe në Kodin e Procedurës Penale nuk parashikohet ndërprerja e parashkrimit të ekzekutimit të vendimeve"dhe se "zbatimi i ligjit penal me analogji nuk lejohet".

Pakica për këtë problem ka mendim të kundërt. Për këtë nuk nisemi vetëm nga fakti që doktrina juridike ka pranuar se instituti i parashkrimit është institut shumëdegësh dhe për këtë arsye parimet dhe konceptet themelore që lidhen me të, të përpunuara gjerësisht nga e drejta civile, janë të zbatueshme, për aq sa kanë sens, edhe nga degë të tjera të së drejtës, siç është edhe e drejta penale. Një koncept i tillë bazë është edhe koncepti i ndërprerjes së parashkrimit.

Vendimi i dënimit penal duhet të ekzekutohet pasi merr formë të prerë. Kur quhet se një vendim merr formë të prerë është e tepërt të analizohet me këtë rast. Duke u nisur nga formulimi i nenit 68 të Kodit Penal se: "Vendimi i dënimit nuk ekzekutohet kur nga dita që ka marrë formë të prerë kanë kaluar:…", arrihet në përfundimin se afati i parashkrimit të ekzekutimit të vendimit fillon të ecë (të llogaritet) nga momenti që vendimi ka marrë formë të prerë. Me këtë rast shtrohet pyetja se çfarë bëhet me afatin e parashkrimit në momentin kur vendimi vihet në ekzekutim, d.m.th. kur i dënuari fillon të vuajë dënimin e dhënë ndaj tij. Përgjigja e kësaj pyetjeje është e thjeshtë, evidente dhe e natyrshme: Afati i parashkrimit ndërpritet. Edhe pse në Kodin Penal ndërprerja e parashkrimit të ekzekutimit të dënimit nuk është parashikuar si koncept juridik, përsëri nuk mund të mohohet që ndërprerja e parashkrimit ekziston si gjendje faktike. Ky fakt nuk mund të mos merret parasysh, ndryshe do të krijohej një non sens. Në qoftë se për një arsye apo një tjetër, për shkaqe objektive apo subjektive, do të ndërpritet procesi i vuajtjes së dënimit penal, gjë që do të thotë ndërprerje e ekzekutimit të vendimit të dënimit atëherë natyrshëm do të fillojë të llogaritet afati i parashkrimit të ekzekutimit të vendimit penal dhe po natyrshëm ky afat do të rifillojë të llogaritet nga momenti i ndërprerjes së ekzekutimit.

Në arsyetimin e saj, shumica operon edhe me termat "pezullim" dhe "zgjatje" e afatit të parashkrimit, të cilat si terma juridike të përdorura në degë të tjera të së drejtës (jo në të drejtën penale) marrin kuptime të veçanta e të ndryshme nga termi "ndërprerje e parashkrimit". Pezullimi dhe zgjatja e e afatit të parashkrimit nuk kanë sens të pranohen si të barazvlefshme me konceptin e ndërprerjes së parashkrimit dhe as si gjendje fakti të lidhura me konceptin juridik të parashkrimit të ekzekutimit të vendimit të dënimit penal. Për rrjedhojë, përdorimi i tyre në këtë çështje në çfarëdo lloj konteksti nuk mund të jetë i pranueshëm.

Shumica ka plotësist të drejtë kur citon se "zbatimi i ligjit penal me analogji nuk lejohet", por përsa i përket problemit të pranimit ose jo të konceptit të ndërprerjes së parashkrimit, përdorimi i këtij pohimi nuk ka vend, thjesht sepse nuk ka lidhje me të. Ndalimi i zbatimit të ligjit penal me analogji, rezulton jo vetëm i parashikuar në mënyrë të shprehur në nenin 1/c të Kodit Penal, por del edhe nga interpretimi në tërësi i përmbajtjes së neneve 1, 2, 3 etj. të Kodit Penal dhe vepron brenda kuadrit të këtyre dispozitave themelore, që përcaktojnë kuptimin e veprës penale e të dënimit; padënueshmërinë e personit për një vepër që më parë nuk është e parashikuar shprehimisht në ligj si e tillë, pse me një lloj apo masë dënimi të paparashikuar shprehimisht në dispozitën përkatëse; kuptimin e veprimit të ligjit penal në kohë, hapësirë e ndaj personave; ndalimin e fuqisë prapavepruese të ligjit penal etj.

Pakica nuk është dakord edhe në përfundimin e nxjerrë nga shumica, sipas të cilit, po të pranohet ndërprerja e parashkrimit të ekzekutimit të vendimit, do të krijohej një pabarazi përpara ligjit midis personave që vuajnë rregullisht dënimin pa ndërprerje, nga njëra anë, dhe atyre që e kanë ndërprerë vazhdimin e mëtejshëm të vuajtjes së dënimit për çfarëdo lloj shkaku, nga ana tjetër.

Rregulli është i njëjtë për të gjithë: kushdo që është dënuar me një vendim penal të formës së prerë duhet t'i nënshtrohet plotësosht vuajtjes së këtij dënimi, sipas llojit dhe masës së dënimit të dhënë. Mosekzekutimi i vendimit apo ndërprerja e ekzekutimit janë raste përjashtimore të imponuara nga shkaqe apo rrethana jo normale në funksionimin e shtetit apo të strukturave të caktuara të tij. Sidoqoftë këto struktura të shtetit kanë të drejtë dhe janë të detyruara të marrin të gjitha masat e duhura për të mundësuar vënien në ekzekutim apo rivënien në ekzekutim të një vendimi dënimi brenda afatit përkatës të parashkrimit. Koha e vënies apo e rivënies në ekzekutim të një vendimi pas ndërprerjes së ekzekutimit, nuk ndikon në, e as kushtëzohet nga sasia e dënimit të vuajtur apo të mbetur ende pa u vuajtur. I vetmi ndryshim është që dikush do ta vuajë më shpejt e dikush më vonë dënimin përkatës që i ka dhënë gjykata. Dënimi do të fillojë të vuhet apo pjesa e mbetur e tij do të rifillojë të vuhet, gjersa ekzekutimi nuk është parashkruar apo nuk është vërtetuar ndonjë shkak tjetër i përligjur që do ta pengonte një gjë të tillë.

Edhe pse shkaqe e rrethana të caktuara, jashtë vullnetit të ligjvënësit, në këto raste krijojnë gjendje

fakti të pabarabarta përsa i përket vuajtjes së dënimit nga grupe të caktuara të dënuarish, këto pabarazi nuk përbëjnë ndonjë diskriminim negativ në kuptim të nenit 18 të Kushtetutës. Në këto raste, për diskriminimin ekziston një përligje objektive. Vetë instituti i parashkrimit të ekzekutimit të vendimit penal përbën në vetvete një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm për ekzekutimin e vendimeve. Është e padiskutueshme që çdo përjashtim nga rregullat e përgjithshme përbën në thelb një trajtim të pabarabartë për kategori të caktuar personash. P.sh. ndër dy të dënuar të gjykuar në mungesë, për shkak se i janë fshehur gjykimit, njeri dorëzohet vullnetarisht dhe i nënshtrohet ekzekutimit të dënimit, ndërsa tjetri vazhdon të fshihet për një kohë të gjatë gjersa të plotësohet afati i parashkrimit. Por në qoftë se kapet, edhe kur ka mbetur vetëm një ditë para se të jetë plotësuar afati i parashkrimit ai do t'i nënshtrohet vuajtjes së plotë të dënimit që i është dhënë. Mund të jepen shembuj të ndryshëm, të cilët tregojnë për një trajtim të pabarabartë, megjithatë nuk mund të pranojmë se është shkelur parimi kushtetues i barazisë para ligjit. Për më tepër diskriminimi qëndron në mohimin e një të drejte për një person apo grupim të caktuar në raport me të tjerët, dhe jo me përmbushjen e një detyrimi ligjor, siç është në rastin konkret detyrimi për ekzekutimin e një vendimi gjyqësor.

Sidoqoftë parabarazia e krijuar si rezultat i zbatimit të institutit të parashkrimit dhe i situatave të ndryshme që mund të krijohen në këtë proces zbatimi, ekziston si një përligjje e arsyeshme dhe objektive (neni 18/3 i Kushtetutës).

Bazuar në arsyetimin e mësipërm, pakica konkludon që si vendimi i shkallës së parë, ashtu edhe vendimi i gjykatës së apelit, në kohën që janë dhënë, e kanë zgjidhur drejt çështjen, prandaj duhej të ishin lënë në fuqi.

Duke qenë se afati i parashkrimit të ekzekutimit të vendimit ka rifilluar të ecë më datë 13.3.1997, kur i dënuari Blerim Llukani është larguar nga burgu (është ndërprerë vuajtja e dënimit), ky afat është plotësuar në datën 13.3.2002.

Zgjidhja e çështjes në këtë mënyrë do të shërbente si motiv nxitës për të dënuarit që janë larguar nga burgjet gjatë trazirave të marsit 1997 për t'u kthyer vullnetarisht në vendet e vuajtjes së dënimit.

Përsa i përket të dënuarit Blerim Llukani, Kolegjet e Bashkuara duhej të ishin shprehur duke përcaktuar si datë të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit datën 13.3.2002, gjë që duhej ta bënte vetë Kolegji Penal më datë 18.4.2002 kur ka gjykuar çështjen.

GJYQTARËT:
P. ZAHARIATH. KONDI
Z. PODAN. KITA

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:
- Kodin Penal (të azhurnuar);
- Kodin e Procedurës Penale (të azhurnuar);
- Përmbledhjen e legjislacionit në fushën e transporteve (Kodin Rrugor dhe ligjin për transportet, e azhurnuar);



U dorëzua për shtyp më 4. 12. 2002
Doli nga shtypi më 5. 12. 2002

Tirazhi: 4250 copë Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 200 lekë